



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni i Posaçëm Parlamentar “Për shqyrtimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve të organeve drejtuese të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve”***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 30.09.2020, ora 17:00

**Drejton mbledhjen:**

**Damian Gjijnuri – kryetar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar**

**Rendi i ditës**

Seancë dëgjimore me kandidatët që i plotësojnë kriteret për pozicionet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve; Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve; Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve

**Marrin pjesë:**

Damian Gjijnuri, Adnor Shameti, Alket Hyseni, Myslim Murrizi, Edmond Stojku dhe Oerd Bylykbashi.

## HAPET MBLEDHJA

**Damian Gjikhuri** – Mirëdita, të nderuar anëtarë të këtij komisioni, deputetë, kolegë, dhe zoti Bylykbashi!

Siç e njoftuam dje, do të vazhdojmë me pjesën e dytë të kandidatëve, që kanë aplikuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Unë do të vazhdoj sipas radhës, që kemi përcaktuar bashkë me sekretarinë.

Kandidati i parë në radhë është Ardian Myslimaj, i cili ka aplikuar për komisioner dhe për anëtar rregullator.

Ju lutem, njoftojeni!

Uluni!

Zoti Myslimaj, shumë shkurt, diçka për karrierën tuaj.

Pse e shikoni veten të kualifikuar për këto pozicione?

Bëni një prezantim jo më shumë se 2-3 minuta, në mënyrë që të na jepet mundësia për pyetje.

Faleminderit!

**Ardian Myslimaj** – Faleminderit!

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Unë jam Ardian Myslimaj. Sipas njoftimit publik të bërë nga Kuvendi i Shqipërisë bazuar në Rregullores së Kuvendit, kam aplikuar për vendin e komisionerit shtetëror dhe të anëtarit të komisionit rregullator.

Shkurt, unë fillimisht kam mbaruar Akademinë Ushtarake në vitin 1991 dhe më pas Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës. Kam kryer një master për studime europiane në Universitetin e Tiranës. Kam kryer kolegjin e lartë të Sigurisë dhe të Mbrojtjes. Jam diplomuar në kursin e lartë ekzekutiv në qendrën e Politikave të Sigurisë Europiane, “Xhorxh Marshall” në Gjermani. Më pas, kam dhënë provime pasuniversitare për detyrat që kam kryer në pedagogji, psikologji e me radhë. Kam mbrojtur gradën “Doktor” dhe më pas, për shkak edhe të aktivitetit tim akademik, të pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme shkencore brenda dhe jashtë vendit, kam fituar titullin “Profesor i Asociuar, Doktor”.

Kjo është për sa i përket CV-së në fushën e arsimit.

Kur kam mbaruar shkollën, kam qëndruar pedagog në Akademinë Ushtarake. Jam larguar dhe kam punuar deri në vitin 1997 si gazetar te “Zëri i Popullit”. Në vitin 1997 kam qenë për 2 mandate deputet i Kuvendit të Shqipërisë, anëtar i Komisionit të Medies,

Komisionit të Integritit, përfaqësues në Asamblenë Parlamentare të NATO-s dhe 2 vjetët e fundit nënkryetar i Komisionit të Sigurisë.

Në vitin 2007 jam rikthyer sërish në Universitetin Ushtarak, një institucion publik i kredituar nga Ministria e Arsimit. Kam qenë pedagog, shef Departamenti dhe më pas në Akademinë e Mbrojtjes si drejtor i Programeve Master dhe Doktoraturë. Kam punuar 1 vit e gjysmë - 2 vjet në një grup task-forcë në Kryeministri dhe prej 4 vjetësh jam administrator në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve, që është shoqëri aksionere.

**Damian Gjiknuri** – Faleminderit, zoti Myslimaj!

Zoti Myslimaj i ka plotësuar të gjithë formularët. Keni pyetje? Suksese!

Natën e mirë!

**Ardian Myslimaj** – Faleminderit!

Punë të mbarë!

**Damian Gjiknuri** – Vazhdojmë me kandidatin e radhës, zotin Ilirjan Celibashi, i cili ka aplikuar për pozicionin e Komisionerit Shtetëror.

Mirëmbërëma!

Zoti Celibashi, shumë shkurt bëni një prezantim, pavarësisht se ju jeni figurë publike, por çfarë ju shtyu të aplikoni sërish për pozicionin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nisur edhe nga fakti që ju keni qenë kryetar në këtë institucion për shumë vjet dhe natyrshëm, edhe komisioni ka, jo vetëm kuriozitet, por duhet të shikojë se si e mendoni ju këtë pozicionim, këtë detyrë të re me organizimin e ri që ka bërë Kodi Zgjedhor, por jo më shumë se 2-3 minuta, për t'u lejuar të tjerëve mundësinë për pyetje!

**Ilirjan Celibashi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Pa dyshim, interesi për ta zhvilluar ndryshe karrierën profesionale ishte shtysa dhe nxitja e parë për të shprehur interesin për të qenë në funksionin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Nga ana tjetër, duke besuar se eksperiencia ime profesionale prej tashmë gati 28 vjetësh në funksione të ndryshme publike, duke filluar nga gjyqtar i Shkallës së Parë, gjyqtar i Gjykatës së Apelit, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, ministër dhe më shumë, për rastin konkret, referuar, si kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve prej rreth 5 vjetësh, kam menduar se është e përputhur me atë profil dhe atë lloj veprimtarie, që duhet të karakterizojë institucionin e ri të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, veprimtari, e cila, më së pari, duhet të jetë e tillë, që të reflektojë integritet, paanësi politike, transparencë dhe, më së shumti, legjitimitet. Duke i parë të gjitha këto, them se do të ishte e dobishme edhe për interesin publik, përfshi këtu, më së pari, të zgjedhësve, të qytetarëve shqiptarë, por edhe të subjekteve zgjedhore të faktorit politik, që kandidatura ime të gjendet e pranuar për këtë funksion.

Faleminderit!

**Damian Gjikhuri** – Keni pyetje?

**Muslim Murrizi** – Përshëndetje, zoti Celibashi!

Duke dashur të mos merrem me asgjë personale, dua t'ju pyes: sa i pavarur ndiheni ju, që konkurroni sot për kryetar, në variantin e vjetër, apo kryekomisioner, sipas variantit të ri, kur keni qenë kryetar i Komisionit Zgjedhor të Zgjedhjeve në vitin 2001, që në dijeninë time, të shqiptarëve, por edhe të ndërkombëtarëve, kanë qenë zgjedhjet më të përfolura, ndoshta edhe më keq se në vitin 1996, dhe kur një zonë elektorale ka prodhuar 10 mandate? A e keni kapërcyer atë prag, përderisa më vonë jeni marrë me politikë, keni qenë deputet i maxhorancës, i PS-së, dhe ministër? A ndiheni ju realisht, pa letra, sepse dokumenti është një letër bakalli për mua, të gjithë bëjnë dorëheqje nga partia, i çliruar shpirtërisht edhe nga diktatet e forcës politike, të cilës prej vitesh, edhe më herët, si ministër i Brendshëm, i keni shërbyer? Nëse do të keni besimin, edhe tonin, edhe të parlamentit, për të qenë kryekomisioner, a jeni siç keni qenë, apo është Ilirjan Celibashi tjetër?

**Ilirjan Celibashi** – Faleminderit, zoti Murrizi!

Më së pari, dua të them se e gjithë veprimtaria ime profesionale dhe aktiviteti im profesional kanë qenë në shërbim dhe në interes të ligjit për rastin kur jam angazhuar në funksione publike. Nuk kam qenë asnjëherë në shërbim të individit, apo të një strukture politike, apo shtetërore, tej përcaktimeve të ligjit për angazhime në raste të tilla.

Pa diskutim që në këtë veprimtari asgjë nuk ka qenë e tillë, që të jetë e lavdërueshme për këdo, por jua them me siguri të plotë se çfarë kam vendosur dhe çfarë kam bërë gjatë këtyre angazhimeve, lidhet thjesht dhe vetëm me atë se si unë e kam menduar dhe si e kam perceptuar atë gjë, dhe aspak me interesat e dikujt tjetër.

Kjo mund të ketë shkuar për llogari të dikujt, për mirë ose për keq, por shtysa nuk ka qenë interesi i të tjerëve.

Faleminderit!

**Damian Gjikhuri** – Keni pyetje tjetër?

Zoti Celibashi, faleminderit! Natën e mirë!

**Ilirjan Celibashi** – Faleminderit ju! Natën e mirë!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Damian Gjikhuri** – Zoti Ilir Rusmali.

Zoti Rusmali, mirë se erdhët në komision!

Shumë shkurt, pavarësisht se ne ju njohim, dhe kemi pasur kënaqësinë të bashkëpunojmë me ju edhe në reformën e fundit zgjedhore dhe, natyrshëm, ju jeni një njohës

i thellë i çështjeve kushtetuese e ligjore. Gjithsesi, për hir të procedurave të këtij komisioni, duhet t'i bëjmë me dije publikut se çfarë ju shtyu të aplikoni për këto dy pozicione? Si e shikoni pozicionin tuaj edhe për faktin që dikur keni qenë anëtar ose eksponent i një partie politike, ashtu si edhe shumë të tjerë që kanë aplikuar këtu, pasi ligji nuk ju përjashton? Pse ju bën kjo të jeni i pavarur në këtë detyrë dhe t'i realizoni me sukses detyrat, për të cilat ju aplikoni?

Ju lutem, shkurt vetëm 2-3 minuta.

**Ilir Rusmali** – Unë do ta filloj nga pyetja e dytë, por, në qoftë se bëhem i bezdisshëm në përgjigje, më ndërprisni, sepse 2 apo 3 minuta nuk i llogaris dot nëse kam shumë për të thënë.

Unë do ta nis nga pyetja e dytë. Eksperienca ime politike është pjesë e historisë sime personale, është pjesë e CV-së sime, pasi prej vitesh nuk jam i angazhuar në politikë. Unë e sodis politikën nga larg, ndonjëherë me emocion, ndonjëherë me endje, ndonjëherë me bezdi, por jam vetëm soditës i politikës.

Nga këndvështrimi i sotëm dhe nga këndvështrimi i këtij kandidimi, eksperienca ime politike fillon dhe mbaron te fjala “eksperiencë”. Nuk ka asnjë kontekst tjetër se si mund të elaborohet: eksperiencë. Unë besoj se në një institucion, që merret drejtpërdrejt me menaxhimin e interesave politikë, siç është KQZ-ja, kjo lloj eksperience është një favor shumë i madh për individin. Duke e njohur politikën nga brenda, ke më shumë mundësi ta vlerësosh siç duhet atë nga jashtë.

Për pyetjen e parë, besoj se është gjëja më e rëndësishme që mund të trajtojmë, unë kam tri motive dhe të tria janë njëlloj të rëndësishme.

Së pari, siç ju e dini dhe siç dihet edhe publikisht, unë kam qenë i përfshirë në radhë të parë në përpjekjet, në punën, në debatet, në diskutimet dhe në negociatat që janë zhvilluar gjatë këtyre viteve për reformën zgjedhore, ku ju keni qenë aktorët, unë kam qenë i përfshirë bashkë me ju. Reforma zgjedhore në këtë pikë ku është sot, do të thotë që është ende e papërfunduar, por ka bërë një hap shumë të madh dhe të rëndësishëm përpara deri tani. Në njëfarë mënyre, ajo ka mbyllur kapitullin e saj të parë, por reforma zgjedhore nuk mbyllet as me atë çfarë është prodhuar, as me atë që është në axhendën e Kuvendit dhe që pritet e shpresoj të miratohet së afërmi. Reforma zgjedhore e kuadrit ligjor mbyllet kur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të kompletojë kuadrin ligjor me akte normative, që është kapitulli i dytë i rëndësishëm dhe zhvillohet i gjithi në fushën e KQZ-së.

Kapitulli i tretë i rëndësishëm është implementimi i kuadrit ligjor. Ne nuk i bëjmë ligjet për qejfin e ligjeve, por i bëjmë që t'i zbatojmë dhe implementimi, gjithashtu, është

domen i KQZ-së. Që të dyja janë hallka shumë të rëndësishme të procesit, madje, në njëfarë mënyre, për të përcaktuar suksesin e reformës janë më të rëndësishmet. Motivi im i parë ka qenë ky. Nëse kam qenë i përfshirë në dorën e parë në bërjen e procesit të reformës deri tani, kam ambicien që procesin e reformës ta çoj më përpara edhe në hallkat e tjera, sigurisht, me dëshirën që kjo të shkojë drejt suksesit.

Motivi im i dytë ka lidhje drejtpërdrejt me KQZ-në. Reforma zgjedhore, praktikisht për herë të parë, do të vendosë në Shqipëri administratën neutrale, administratën e pavarur zgjedhore dhe kjo është sfidë historike për menaxhimin e zgjedhjeve në Shqipëri dhe që të kesh mundësinë të ngresh dhe të konsolidosh një strukturë, që vendoset për herë të parë në historinë e vendit tënd, sigurisht që është një privilegj i jashtëzakonshëm, një privilegj nga i cili është e vështirë të hezitosh. Ky është motivi im i dytë.

Motivim im i tretë, në fakt, ka lidhje me ju, si politikë, me ju, si individë, pasi keni qenë të gjithë të përfshirë në këtë proces reforme; të gjithë keni qenë aktorë të saj, por jeni edhe përfaqësues të partive tuaja. Gjatë procesit të reformës unë kam konstatuar me shumë kënaqësi një gjë që, për fat të keq, jo të gjithë e kanë vënë re. Kam konstatuar se të gjitha partitë politike në Shqipëri e duan administratën zgjedhore të pavarur. Pra, i gjithë spektri politik do që Shqipëria një orë e më parë të ketë një administratë zgjedhore të pavarur. Ky vullnet kaq i pastër, kaq i qartë, kaq i hekurt, sigurisht, është burim frymëzimi dhe burim optimizmi për të marrë përsipër dhe për të përballuar një detyrë kaq të vështirë, siç është ngritja e konsolidimi i një administrate të pavarur zgjedhore në Shqipëri.

Këto janë motivet e mia pse unë kërkova të kandidoj për komisioner shtetëror. Unë besoj se sfida e madhe e institucionit është sfida që duhet të përballojë komisioneri shtetëror, pa nënvlerësuar sfidat e rregullatorit apo të KAS-it, por komisioneri shtetëror është, në fakt, në themel të institucionit për sa u përket nevojave, për sa u përket problemeve, për sa u përket sfidave, për sa i përket edhe presionit, po të doni. Pa komisionerin shtetëror, institucioni mund të fillojë të lëkundet dhe dy hallkat e tjera vështirë se e mbajnë dot në këmbë.

**Adnor Shameti** – Përshëndetje, zoti Rusmali!

Në radhë të parë, dua të jap konsideratën time personale në lidhje me pozicionet ku ju aplikoni. Në bindjen time personale, jo politike, aplikimi nga ana juaj i bën nder procesit dhe për ju kam veçse vlerësimet më të larta, duke e vlerësuar staturën tuaj dhe standardin që ju keni vendosur, sepse mbaj mend dorëheqjen tuaj nga kabineti qeveritar vite më parë për diçka që nuk kishte fare lidhje me ju, i cili përbën një standard që, për fat të keq, nuk është ndjekur as para jush dhe as pas jush. Unë kam një apo dy pyetje të shkurtra.

E para, jam i sigurt që edhe media, edhe opinioni publik do të orvaten ta bënë këtë pyetje. Duke qenë vazhdimisht në cilësinë e ekspertit për dhënie mendimi që nga Komisioni i Posaçëm i Reformës Zgjedhore i konstituuar në vitin 2017 e në vijim, a ndiheni ndopak në konflikt interesi? Besoj se të gjithë e bëjnë këtë pyetje.

Së dyti, a ndieni i çliruar nga “dashuritë” e vjetra politike në kryerjen e këtij misioni, për të cilin keni aplikuar?

Faleminderit!

**Ilir Rusmali** – Në radhë të parë, dua t’ju falënderoj për vlerësimin personal. Edhe unë, personalisht, jam shumë mirënjohës që keni këtë vlerësim. Unë mund t’u përgjigjem pyetjeve, nëse më lejoni.

Unë e vlerësoj eksperiencën politike si eksperiencë dhe kaq. Jam distancuar nga aktivizimi im politik për motivet që tashmë dihen. Unë mund të them se për cilën parti politike votoj dhe këtë mund ta them hapur, nuk e kam problem, por, në qoftë se e konsideroni që sekret i votës nuk e meriton të nëpërkëmbet, unë e lë këtë gjë. Ajo që mund t’ju them, dhe për këtë nuk mund të më pengojë njeri, është se, në qoftë se e imagjinoj veten komisioner shtetëror, nuk mund të them se nuk do t’i lexoj ndonjëherë gazetën, nuk do të ndjek ndonjëherë konferencat e shtypit, se këtë nuk kam pse ta them. Pra, unë mund t’ju them se do të ishte standardi më i keq, në qoftë se vendosej që nga pozicioni komisionerit shtetëror, për shembull, votimit si shtetas, si qytetar, t’i rrijë larg. Ky është neotropitet. Komisioneri, për shkak se menaxhon procesin, nuk e shfrytëzon dot të drejtën e tij për të votuar, sepse kandidimin për poste ia ka ndaluar ligji. Ky mund të ishte një standard që unë mund ta imagjinoja nga pozicioni i ardhshëm i komisionerit. Ndërsa kështu, besoj se jam votues i rregullt. Kam votuar pothuajse gjithmonë, por jo gjithmonë. Kur nuk kam votuar kam qenë i penguar për motive që nuk kanë pasur lidhje me zgjedhjet. Kjo për sa u përket raporteve me politikën.

Për sa i përket konfliktit të interesit, këtu ka një lloj keqkuptimi popullor, prandaj po i referohem keqkuptimit të publikut, ku shikohet konflikti i interesit pas çdo lloj veprimtarie të individit. Konflikti i interesit është një gjë e pastër dhe shumë e thjeshtë, që nga pozicioni i interesit privat të abuzosh në kompetencën tënde vendimmarrëse publike.

Raporti im me reformën zgjedhore, me ekipet, me komisionin, me Këshillin Politik apo ku di unë, ka qenë raport i një eksperti. Unë strukturave vendimmarrëse jam përpjekur që gjatë gjithë kohës t’u jap ekspertizën time më të mirë dhe më të kualifikuar, por unë, në asnjë nga rrethanat nuk kam qenë pjesë e vendimmarrjes së institucionit.

Unë kam shkruar vetë, dhe për një pjesë në bashkëpunim, mori të neneve të dispozitave të ligjit që keni miratuar, mori të drafteve që i keni pasur dhe që i keni skartuar, mori të drafteve që i keni ende në shqyrtim, por unë skam miratuar asnjërin prej tyre dhe nuk gëzoj të drejtën të quhem autor i asnjë neni të reformës. Unë kam punuar për të gjitha, por nuk jam unë autori. Autorët jeni ju, Komisioni i Ligjeve dhe Kuvendi i Shqipërisë, pra ju që i keni miratuar, ju që i keni dhënë votën dhe jetën. Prandaj nga kjo pikëpamje, debati për konfliktin e interesit është debat që nuk shtrohet dot për një ekspert, i cili kontribuon me ekspertizë, por nuk ka asnjë të drejtë vendimmarrëse.

**Myslim Murrizi** – Unë nuk kam pyetje, por më shumë kam shprehje të opinionit tim personal, besoj edhe në emër të grupit politik që unë përfaqësoj sot në Kuvend. Unë nuk e quaj fare konflikt interesi, sepse keni ardhur në politikë jo si militant dhe jeni larguar nga politika në mënyrën më dinjitoze që mund të largohet një njeri nga politika në këta 30 vjet post komunizëm. Ndoshta shumë çuditëshin në atë kohë që je larguar nga politika, por kjo është pjesë e karakterit dhe pjesë e dinjitetit. Ajo që unë shikoj te figura juaj, përveç teknikentit, është eminenca gri, që ke bërë ligje dhe ne kemi ngritur dorën, unë në këtë periudhë 18-muajshe jashtë PD-së, por jo pak të tjerë që nga viti 2013 e këtej.

Unë besoj se ne kemi luksin si Kuvend dhe si komision, që një figurë kaq e madhe në ushtrimin e funksioneve publike dhe politike, sepse ke qenë zëvendëskryeministër, ofrohet për të qenë komisioner. Në këta 74 kandidatë, 21 janë eliminuar pa ardhur në këtë seancë pyetjesh, pra në 53 emra, unë nuk di se çfarë, por nuk shikoj cent në qenien tuaj. Ju jeni një njeri që do të përmbushni me sukses dhe në mënyrë dinjitoze, ndoshta për herë të parë pas 31 vjetësh post komunizëm, për të pasur një palë zgjedhje që të pranohen nga palët.

Konflikte interesi kemi parë këtu, por nuk kanë lidhje me ju. Të gjithë ata që hartuan ligjet e të famshmes “reformë në drejtësi”, edhe pse e kishin të shkruar dhe të ndaluar me ligj që nuk do të ishin pjesë vetë, sot janë drejtues të KLP-së, KLGJ-së dhe gjithandej. Prandaj nuk shikoj asnjë konflikt interesi dhe shpreh konsideratën maksimale.

Absolutisht që do t’ju votoj. Ju, si qytetar nuk keni përse të na e thoni votën, sepse është sekret, por votën time si anëtar i komisionit këtu dhe në parlament do ta kem pro jush, duke menduar që i bëj nder zgjedhësve shqiptarë, forcave politike shqiptare, jo vetes time, për të ruajtur procesin zgjedhor të 25 prillit në integritet, për aq sa i kam parë të gjitha kandidaturat që janë këtu.

Faleminderit që ke aplikuar!

Mos u mërzit, sepse do të bëjnë foto edhe kur je duke pirë kafe me Damianin. Bolshevizmi është ulur këmbëkryq që në 1945 në Shqipëri dhe 75 vjet vazhdon të jetë



agjitacion e propaganda, lufta e klasave dhe bilbilfryrësit, siç më nxjerrin mua në foto, do të nxjerrin edhe ty me Damianin apo me Adnorin. Por, do të sugjeroj të marrësh pak përvojë nga unë edhe pse më i vogël në moshë, një mendje të lehtë dhe përplasja në serrat të gjithë atyre që merren me këtë punë. Mua më ka dal për hajër dhe kam 30 vjet që më duken, këta që e shikojnë veten të mëdhenj, si tullumbace të fryrë me fleta preshi brenda.

Faleminderit që ke kandiduar, duke i bërë nder zgjedhjeve, komisionit dhe qytetarëve shqiptarë më 25 prill, jo Myslim Murrizit dhe as Damian Gjikhurit.

**Ilir Rusmali** – Unë ju falënderoj për vlerësimin dhe për këshillën!

**Edmond Stojku** – Dua të jap një konsideratë personale.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk është deklarim vote. Në Kuvend kemi pasur disa marrëdhënie ekspertize, por nuk është vetëm kjo, por është edhe ajo njerëzore. Pra, emocionet pozitive ndjesore që kam pasur me zotin Rusmali, me atë komunikim sa kam pasur, më kanë lënë të kuptoj që është krejt e vërtetë ajo që zoti Rusmali deklaroi, si në aspektin moral, ashtu dhe në aspektin teknik. Pres, në të vërtetë, që në historinë e Shqipërisë të hyjë si një datë e thyerjes së prishjes së zgjedhjeve nga organet zgjedhore, duke filluar nga kryetari i KQZ-së së re ose kryekomisioneri në rastin konkret. Nuk di se çfarë të them më shumë se kaq.

Urime dhe suksese!

**Ilir Rusmali** – Faleminderit!

**Damian Gjikhuri** – Zoti Rusmali, unë u shterova nga konsideratat, sepse nuk më lanë më vend kolegët. Nuk po e shpreh opinionin tim për ta lënë surprizë deri në fund. Megjithëse e kam pasur kënaqësi të madhe të bashkëpunoj me ty.

**Ilir Rusmali** – Faleminderit dhe punë të mbarë!

**Damian Gjikhuri** – Radhën e ka Irena Nino.

Zonja Nino, shumë shkurt na thoni për *backgroundin* tuaj dhe çfarë ju shtyu të aplikoni? Keni 2-3 minuta kohë për të lënë hapësirë edhe për ndonjë pyetje.

**Irena Nino** – Në bazë të shpalljes që bëri Kuvendi i Shqipërisë për plotësimin e vendeve vakante në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kam shprehur interesin tim për të aplikuar në një pozicion të lirë si anëtare e Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve. Jam motivuar për arsyet e mëposhtme;

Kam përfunduar fakultetin e drejtësisë në Universitetin e Tiranës në vitin 1985 me mesatare note 9,8. Jam diplomuar si juriste dhe kam filluar punë si prokurore, ku kam punuar rreth 20 vjet, ku 7 vjet e gjysmë kam punuar në Prokurorinë e rrethit të Shkodrës, 8 vjet në

Prokurorinë e Përgjithshme dhe pjesën tjetër në Prokurorinë e Tiranës. Jam larguar me kërkesën time. Nga vitin 2015 e në vazhdim ushtroj profesionin si avokate.

Gjatë gjithë kohës që kam punuar në prokurori, si dhe në detyrat e tjera jam përpjekur me vendosmëri të zbatoj me korrektësi ligjin si dhe të ruaj një figurë të pastër morale dhe të rris performancën time profesionale. Kam marrë pjesë në të gjitha seminarët dhe aktivitetet që ka organizuar prokuroria dhe sistemi i avokatisë, si në bashkëpunim me prokurorinë gjermane, italiane, si dhe aktivitetet që ka bërë ambasada e Shteteve të Bashkuara, kualifikime të ndryshme dhe me misionin PAMECA.

Gjithashtu, së fundmi, nga viti 2018, për dy vjet rresht jam zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë si anëtare e komisionit të pavarur të monitorimit për ndjekjen e reformës në drejtësi, detyrë të cilën e kam përfunduar në korrik të viti 2020. Duke menduar se i zotëroj aftësitë dhe cilësitë, kërkoj nga ky komision që të më lejohet të konkurroj për një vend në Komisionin e Ankesave dhe të Sanksioneve. Gjithashtu, dua të them që nuk kam qenë asnjëherë pjesë e ndonjë partie politike dhe këtu kam aplikuar me dëshirën time duke menduar se mundem dhe duhet të jap një kontribut që reforma zgjedhore të përfundojë sa më mirë.

**Myslim Murrizi** – Ju keni aplikuar për KAS-in, apo jo? Një nga kriteret thotë që duhet të ketë një farë përvojë në gjykimet administrative. Më fal, keni qenë prokurore?

**Irena Nino** – Po, kam qenë prokurore dhe gjatë kohës që kam qenë në prokurori, fillimisht kam qenë...

**Myslim Murrizi** – Sa vjet keni qenë prokurore?

**Irena Nino** – 20 vjet.

**Myslim Murrizi** – 20 vjet prokurore?

**Irena Nino** – Po.

**Myslim Murrizi** – Tërhiqem nga pyetja. Faleminderit!

**Oerd Bylykbashi** - Më falni edhe një herë, ju keni qenë avokate nga viti 2015?

**Irena Nino** – Po, 2015, kam marr licencën.

**Oerd Bylykbashi** - Pra , keni eksperiencë edhe në gjykimin administrativ.

**Irena Nino** – Po, në prokurori 20 vjet, mandej...

Por edhe gjatë kohës që kam qenë në prokurori, fillimisht prokuroria ka qenë e organizuar në 3 sektorë, sektori i kontrollit të përgjithshëm, penali dhe gjyqësori, kam punuar te sektori i kontrollit të përgjithshëm, që ka ndjekur anën administrative. Së fundi, në Prokurorinë e Tiranës kam pasur në hetim, në ndjekje dhe në gjykim, çështje që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor, domethënë me falsifikime, me krime zgjedhore.

**Myslim Murrizi** – Edhe një pyetje në mirëkuptim me zotin Bylykbashi, në cilin vit jeni larguar si prokurore dhe pse?

**Irena Nino** – Jam larguar në vitin 2004 me kërkesën time, për arsye familjare.

**Myslim Murrizi** – Ah, nuk je kjo pjesa e vetingut?

**Irena Nino** – Nuk kam arritur të korruptohem. Kam ikur shumë më përpara.

**Myslim Murrizi** – Këtë mos e quaj si avantazh të madh, se mërzitet politika. Faleminderit!

**Irena Nino** – Faleminderit!

**Damian Gjikhuri** – Radhën e ka zonja Ilirjana Nano.

Atëherë, zonja Ilirjana, shumë shkurt pse vendosët të kandidoni dhe pak për formimin tuaj, që përshtatet me pozicionin e komisioneres në Rregullator, pra të anëtares së Komisionit Rregullator. Dy-tre minuta, sepse duhet lënë mundësia edhe për pyetje.

**Ilirjana Nano** - Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të komisionit, ju falënderoj që më keni thirrur në këtë seancë dëgjimore! Përgjigjen e pyetjes që ju sapo më drejtuat dua ta ndaj në dy pjesë.

Së pari, dua ta shikoj në aspektin teknik dhe të kontributit në hartimin e normave, eksperiencë kjo e kërkuar për Komisionin Rregullator dhe dua të them që kam aplikuar vetëm për këtë pozicion duke vlerësuar te vetja që eksperiencat e mia, për një periudhë 24-vjeçare pas diplomimit tim si juriste, janë më të vlefshme në Komisionin Rregullator.

Sigurisht që gjatë 24 vjetëve si juriste kam pasur eksperiencë nga më të ndryshmet profesionale në institucionet publike të nivelit të lartë, në institucione private, duke ofruar ekspertiza dhe konsonanca edhe për organizatat vendase dhe ndërkombëtare. Unë i kam parë aplikantët dje dhe sot, dhe një pjesë e mirë kanë referuar llojet e akteve nënligjore dhe të ligjeve në të cilat kanë bërë pjesë në grupe pune, ku kanë ofruar ekspertizën, kështu që, unë mendoj se çdo jurist me një eksperiencë mbi 20-vjeçare, sigurisht gjen te vetja eksperiencë të tilla.

Unë dua të veçoj një nga eksperiencat më mbresëlënëse për mua, por edhe kontribut do ta quaja, jam angazhuar në reformën në drejtësi që në fillimet e saj, që në fillim të vitit 2015. Kam qenë pjesë e sekretariatit teknik, veçanërisht në grupin e punës për masat antikorrupsion, ku besoj që kam dhënë një kontribut qoftë në hartimin e strategjisë të planit të veprimit, por dhe të disa ligjeve të reformës.

Ndërkohë, pjesën e dytë të përgjigjes, dua ta shikoj në planin personal dhe në planin qytetar, pse kam aplikuar. Jemi të gjithë qytetarë të këtij vendi, por unë mendoj që ka qytetarë indiferentë, që ditën e zgjedhjeve rrinë në shtëpi dhe as nuk votojnë, ka qytetarë që e ndiejnë

detyrën e tyre qytetare për të votuar dhe shkojnë në kutinë e votimit, ka qytetarë që janë tifozë, ka qytetarë që janë anëtarë të partive, militantë apo drejtues të organeve të partive politike. Përveçse si një qytetare e përgjegjshme për të votuar sa herë që ka zgjedhje, unë e konsideroj veten qytetare aktive dhe një qytetare që dëshiroj të kontribuoj. Kështu që, në këto kushte, nëpërmjet ndryshimeve kushtetuese, nëpërmjet ndryshimeve të Kodit Zgjedhor të realizuar dhe ato të pritshme, nëpërmjet rikompozimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, unë e gjeta me vend që të aplikoj dhe të jap kontributin tim në Komisionin Rregullator, ku, siç ju thashë edhe më herët, mendoj që kam një eksperiencë më të gjatë në raport me pozicionet e tjera, për të cilat janë shpallur vakancat nga Kuvendi.

Faleminderit!

**Myslim Murrizi** – Aktualisht, jeni vetëm pedagoge?

**Iirjana Nano** - Aktualisht jam pedagoge, por ende nuk e kemi filluar vitin e ri akademik.

**Myslim Murrizi** – Po, do e fillosh sa t'i japë urdhër Damiani Evis Kushit, nga data 2 nëntor.

Keni qenë te reforma në drejtësi? Keni punuar me ndonjë komision apo thjesht asistente e legjislacionit për reformën në drejtësi?

**Iirjana Nano** - Zoti Murrizi, faleminderit!

Në kuadër të reformës në drejtësi, unë jam angazhuar si eksperte e sekretariatit teknik, si koordinatorë për grupin e masave antikorrupsion dhe në zyrën e sekretariatit teknik, pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit. Kontributi ka konsistuar, së bashku me jo pak kolegë ekspertë të nivelit të lartë dhe sekretarit teknik, në hartimin e analizës së dokumentit voluminoz që u miratua nga Kuvendi, analizës së sistemit të drejtësisë, posaçërisht në masat antikorrupsion dhe strategji në planin e veprimit, kontribut në hartimin e disa prej ligjeve të cilat një pjesë u ndryshuan, një pjesë u hartuan nga e para.

**Myslim Murrizi** – A keni qenë në ndonjë parti politike?

**Iirjana Nano** - Jo, zoti Murrizi.

**Myslim Murrizi** – Ju falënderoj për përgjigjen! Do ta keni votën time pro publikisht, sepse je e vetmja nga ata që kanë hartuar ligjet në reformën në drejtësi, që nuk ke zënë një cep vetë tek organet e reformës në drejtësi.

**Iirjana Nano** - Faleminderit!

**Damian Gjikhuri** – Deklarove shumë vota deri tani, mbaruan kandidatët.

Faleminderit! Natën e mirë!

**Iirjana Nano** - Faleminderit! Punë të mbarë!

**Damian Gjikhuri** – Radhën e ka zonja Irsa Ruçi.

Irsa, shumë shkurt, përse ke aplikuar për këto pozicione dhe formimin tënd, dy-tre minuta, sepse më pas ka hapësira për ndonjë pyetje.

**Irsa Ruçi**- Faleminderit!

Quhem Irsa Ruçi, kam mbaruar studimet e larta për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun, diplomuar me dy medalje ekselence. Në fakt, kjo është ndoshta një nga pikat e mia më të forta, që, nuk e di nëse ka vlerë, por për mua ka pasur gjithmonë në karrierën time. Kam medalje ekselence, aq sa kam edhe vite studimi. Kështu që...

*(Ndërhyrje)*

Jo, jo, jam pas '90-ës, kështu që më kap procesi demokratizues!

Për shkak të rezultateve, kam nisur punën si lektore pranë Departamentit të Gazetarisë në Universitetin e Tiranës fill pas diplomimit, një pozicion të cilin e ushtroj edhe aktualisht me shumë pasion e dëshirë.

Disa vite më vonë, pas diplomimit, kam nisur punën në Departamentin e Komunikimit në Kryeministri për të qenë pjesë e stafit të fjalimshkruesve të atij institucioni, një detyrë të cilën e kam mbajtur për një periudhë rreth 5 vjet deri në fillim të vitit 2019, kur ndieva se ishte e nevojshme mbyllja e një cikli për të mos e çuar veten në monotoni. Kështu që kërkova një hapësirë të re, ku të rigjeneroja energjitë e mia dhe gjeta një institucion, i cili kishte nevojë për një drejtim të mirë dhe për mua ishte një sfidë. Prej fillimit të vitit 2019 kam qenë drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar për Rininë, institucion i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Ju kërkoi ndjesë për modestinë, që do ta lë pas në këtë moment, por atë institucion e quaj si krijesën ime, sepse arrita të jepja një rezultat jashtëzakonisht shumë pozitiv, duke dhjetëfishuar punën, në krahasim me çdo vit që prej krijimit të atij institucioni në vitin 2014. Këto të gjitha janë të faktuara me raporte zyrtare. Integritetin, si te puna e mëparshme, edhe tani, e vërtetojnë vlerësimet vjetore, të cilat kanë qenë gjithmonë maksimale, ndërsa aftësinë time shkruese prej moshës 14 vjeç e kam të dokumentuar me çmime të ndryshme: në moshën 17-vjeçare kam fituar çmimin e parë në Shqipëri në letërsi, e dhënë nga Ministria e Kulturës së asaj periudhe; kam mbi 90 botime kombëtare dhe ndërkombëtare në antologji, gazeta dhe revista të huaja e vendase, si dhe jam nominuar para disa vitesh për çmimin “Pushkash”.

Kjo është pak a shumë eksperiencia, duke përmendur edhe faktin që gjatë vitit të kaluar kam qenë lektore pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike në lëndën “E drejta për informim”. Jam autore e katër librave. Në proces është një libër, i cili është më tepër profesional dhe ka të bëjë me partitë politike, fushatat elektorale, zgjedhjet ta para në

këndvështrimin e marrëdhënieve me publikun dhe të komunikimit publik. Për ta përmbyllur pak a shumë eksperiencën profesionale, arsyeja pse kandidova lidhet me një qëllim të caktuar: për t'i dhënë një frymë të re institucionit. Para disa kohësh në Gazetën Shqiptare kam botuar një artikull, ku them se demokracia ka nevojë për frymë dhe jo për shpatë. E vlerësoj shumë faktin që pjesa teknike ka treguar që janë juristë të mirë, gjë e cila u vlen jashtëzakonisht shumë komisioneve, të cilat do të merren me hartimin e ligjeve dhe normave juridike, por ajo që unë vlerësoj te komisioneri është se nuk e shoh një figurë as burokratike, as teknike, por e shoh shumë përtej kësaj dhe, nëse do të kisha drejtimin e këtij institucioni, me përgjegjësi të plotë do ta thosha, ndoshta jam e vetmja dhe shkoj pak përtej kornizave, por do të isha thellësisht politike dhe aspak partiake. Besoj se për këtë ka nevojë ky institucion për t'u rritur, për të shpërndarë frymën e besimit te njerëzit, për të risjellë një energji të re, e cila ka nevojë të instalohet bashkë me ndërtimin e një institucioni të ri.

Është e rëndësishme të shihet në këtë mënyrë, pra si një rigjenerim i vlerave të këtij institucioni, të cilat, nëse nuk do të ishte e nevojshme, mund të mbeteshin siç ishin.

Faleminderit juve!

**Damian Gjikhuri** – Një pyetje, se më bëri përshtypje dhe, shumë mirë që e the, pa modesti, se, në fund të fundit, gjërat që kanë vlerë dhe që quhen arritje, edhe duhen deklaruar, kur thatë: “E quaja atë shërbim si fëmijën tënd”, pse e le fëmijën tënd, në kuptimin simbolik të fjalës?

**Irsa Ruçi** – E para, institucioni është në proces ristrukturimi.

E dyta, unë dhashë gjithçka që doja të jepja. Pra, unë i kam mbyllur vetë ciklet në çdo punë ku kam qenë, kur kam ndier që ajo që kam dhënë ishte më e mira imja që mund të jepja. Brenda një viti, e thashë, dhjetëfishova punën dhe e ktheva atë institucion në ekselent, tashmë aq shumë të lakmueshëm. Kështu që besoj se nuk kam çfarë të jap më tepër nga sa dhashë në një vit të tërë. Dhashë më të mirën time dhe atë që unë desha, e arrita.

**Damian Gjikhuri** – Pra, e linde fëmijën dhe e braktise, megjithëse bëre të kundërtën.

**Irsa Ruçi** – Jo, e linda, e rrita dhe e çova përpara, i dhashë hapësirë që tashmë të ketë një energji të re edhe ajo.

**Damian Gjikhuri** – Dakord.

**Myslim Murri** – Vetëm se një merak kam unë, zonja Irsa. Shoh që në institucionet ku ke qenë, ke mbaruar punë shpejt. Kam hall që ky është institucion me mandat katërvjeçar ose pesëvjeçar dhe mos na kënaqesh për një vit e na e lë dyfekun në faqe ato katër vjetët e tjerë.

**Irsa Ruçi** – Më falni! E para, kur unë marr përsipër një përgjegjësi, e marr me synimin ta çoj deri në fund. Nëse ka qenë e shkurtër ajo periudhë njëvjeçare, flas ajo e fundit, se e para ka qenë gjashtë vjet, atëherë do të thotë që unë e kam mbaruar misionin tim. Nëse ky mision do të jetë shumë më i gjatë, dhe unë uroj që të jetë i gjatë, sepse tregon përgjegjësi mandati, atëherë unë e marr përsipër. Përderisa kam aplikuar, do të thotë që e pranoj këtë përgjegjësi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Damian Gjikhuri** – Faleminderit!

Vijojmë me zotin Ismail Tafani, i cili ka aplikuar për komisioner dhe për nënkomisioner.

Ismail, shumë shkurt, çfarë të shtyu të kandidosh për këto dy pozicione, na thuaj diçka në lidhje edhe me *background*-in tënd, por 2-3 minuta, sepse ka edhe pyetje.

**Ismail Tafani** – Kam mbaruar studimet e larta për drejtësi në Bolonja. Po në atë qytet kam mbaruar edhe studimet e ciklit të tretë “Doktoraturë”. Vij nga bota akademike. Jam përgjegjës i Departamentit të Shkencave Juridike dhe lektor pranë një universiteti në Shqipëri.

Një ndër arsytet pse unë kam zgjedhur të kandidoj në këto dy pozicione është fakti sepse, duke menduar natyrën personale dhe formimin tim profesional, mendoj që gëzoj një integritet si individ, i cili është aq i nevojshëm për procesin që pritet të menaxhohet nga këto figura për të cilat ne kandidojmë.

Besoj se mora më pak kohë nga sa kërkohej.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Damian Gjikhuri** – Faleminderit!

**Ismail Tafani** – Faleminderit juve!

**Damian Gjikhuri** – Natën e mirë!

**Ismail Tafani** – Faleminderit juve! Gjithë të mirat!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Damian Gjikhuri** – Vijojmë me zonjën Iva Nathanaili, e cila ka aplikuar për rregullatore dhe KAS.

Iva, mirëmbërëma! Shumë shkurt pak për *background*-in tuaj dhe pse keni aplikuar për këto dy pozicione?

**Iva Nathanaili** – Mirëmbërëma!

Përshëndetje, anëtarë të komisionit!

Unë jam Iva Nathanaili. Vij këtu nga profesioni i lirë i avokatit. Në këtë cilësi kam kryer edhe aplikimin qoftë në një nga komisionet e reja dhe thirrjet që ju keni hapur. Kam studiuar drejtësi në Fakultetin Juridik në Tiranë. Më pas kam vijuar studimet në *King's College*, Londër, Angli.

Kam zgjedhur të rikthehem në Shqipëri, pasi kam kryer një master, në fakt, pak të veçantë për tregun tonë: “E drejtë ndërkombëtare financiare”. Këtu kam filluar punë dhe kam marrë formimin tim si juriste më së shumti në studio ligjore, ku kam punuar për disa vjet. Nuk e di nëse keni pak njohuri se si janë punët në studiot ligjore, por është një punë shumë intensive me ekspozim të madh përkundrejt ligjit, interpretimeve ligjore dhe performancës së lartë që kërkohet në punët në këto studio.

Më pas kam punuar edhe në administratë, ku kam qenë në Zyrën e Koordinatorit kundër Korrupsionit. Gjatë këtij viti eksperience kemi njohur shumë administratën në nivel lokal, por edhe atë rajonal, kemi përfaqësuar Shqipërinë në institucionet kundër korrupsionit të Këshillit të Europës, kemi dorëzuar draftin përfundimtar të ligjit “Për mbrojtjen e sinjalizuesve”, ligj që përdoret edhe sot.

Gjithashtu, kam punuar shumë si eksperte e pavarur në hartimin e ligjeve të ndryshme, sidomos me UN-në, me Kombet e Bashkuara. Kam punuar sidomos me legjislacionin në rregullimin e fushës së punës këtu në Shqipëri. Kjo i ka hapur rrugë një eksperience më të gjatë po me Kombet e Bashkuara, ku kam punuar për 3 vjet me radhë, e cila i ka dhënë një dimension tjetër eksperiencës dhe karrierës sime sidomos në çështjet e menaxhimit të projekteve, duke punuar shumë në terren me grupet në nevojë, me adresimin e nevojave të këtyre grupeve, identifikimin e liderëve në komunitet, me zgjidhjen e problemeve, sidomos të çështjeve që ndeshim në praktikë. Dy vjetët e fundit unë punoj edhe si avokate me profesion të lirë, kam praktikën time, ku merrem me çështje civile dhe administrative, si dhe përfaqësim ligjor.

Arsyeja pse unë aplikoj sot është se unë kam zgjedhur të jetoj në Shqipëri, të krijoj familjen time këtu dhe të punojmë këtu. Pra, iu përgjigja thirrjes me dëshirën e mirë për të qenë pjesë e këtyre institucioneve të reja që po ngrihen në vend, të cilat premtojnë ndryshime dhe përmirësime.

Faleminderit!

**Damian Gjikhuri** – Faleminderit!

Pra, keni eksperiencë disavjeçare në shqyrtimin e çështjeve administrative, konflikteve e të tjera, sepse është kërkesë e ligjit që të paktën duhet të kesh 3 vjet eksperiencë?



**Iva Nathanaili** – Tashmë bëhen mbi 10 vjet, sepse kam filluar të punoj shumë shpejt.

Unë e shikoj veten time më të fortë në çështjet e ankimeve administrative, me të cilat jam marrë shumë si avokate dhe si konsulente, por edhe në çështjet e hartimit të ligjeve dhe akteve nënligjore, ku jam përfshirë si eksperte e pavarur, por edhe si konsulentë, ku kam punuar dhe asociuar në studio.

Faleminderit dhe punë të mbarë!

**Damian Gjikhuri** – Radhën e ka Kamerion Salillari.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Kamerion Salillari** – Mirëmbërëma!

**Damian Gjikhuri** – Mirëmbërëma!

Kamerion, ju lutem prezantohuni shumë shkurt, për dy-tre minuta, pse eksperiencia juaj është e përshtatshme dhe çfarë ju shtyu të aplikoni për këtë pozicion. Ju jeni kualifikuar vetëm për pozicionin në komisionin e ankimeve dhe sanksioneve.

**Kamerion Salillari** – Atëherë, po bëj thjesht një prezantim timin.

Unë quhem Kamerion Salillari, lindur më 23 shtator 1984 në Durrës dhe aktualisht banues në Durrës. Kam kryer studimet e larta në shkencat juridike në universitetin jopublik... Prej datës së diplomimit më tepër kam qenë pjesë e profesionit të lirë. Kam ushtruar detyrën e anëtarit të komisionit pranë Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë pranë prefekturës Durrës prej 8 muajsh dhe për një kohë të shkurtër pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës si funksionar i zyrës juridike. Nga viti 2017 dhe deri më sot kam një shoqëri timen, në të cilën jam pjesë si ortak dhe si përfaqësues ligjor dhe administrator i kësaj shoqërie.

Në momentin që u shpall nga Kuvendi se u ndryshua ligji i Kodit Zgjedhor dhe se ishte e nevojshme përzgjedhja e anëtarëve të rinj, e pashë të arsyeshme të aplikoj, sepse mendoj se kam arritur pjekurinë profesionale, por dhe si individ, për të qenë pjesë e kësaj strukture, që në vetvete besoj se mbart një detyrim shumë të madh ligjor dhe moral, por, në gjykimin tim, edhe për të kontribuar në përmirësimin e zgjedhjeve në republikën e Shqipërisë. Kjo ishte një nga shtysat e para.

Shtysa tjetër, që besoj se është e rëndësishme, është edhe pjesa e shpërblimit, sepse në momentin që ofrohet një shërbim, ofrohet edhe një shpërblim. Besoj se kjo do të ndihmonte në përmirësimin social-ekonomik të familjes sime. Besoj se është shumë normale.

**Damian Gjikhuri** - Je i vetmi që e ke thënë këtë. Paketa ekonomike që ofrohet është atraktive. Të gjithë thonë sikur duan të sakrifikohen. Më pëlqeve, realisht.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ka pyetje?

**Myslim Murrizi** – Edhe unë e vlerësoj shumë sinqeritetin dhe pragmatizmin e zotit Kamerion, sepse, në fakt, edhe KAS-i, edhe rregullatori ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Këta të tjerët nuk e thonë, sepse mendojnë se i shërbejnë me devotshmëri atdheut. Gjithsesi, të dyja janë funksione ku punohet *part time* (KAS-i të paktën) dhe do të kenë një muaj punë një herë në dy vjet. Shikoj që kanë aplikuar shumë punonjës institucionesh, përfshirë edhe të Kuvendit, të cilët i kanë rrogat nga 1 milion e kusur lekë, por që kanë dëshirë të marrin edhe 10 milionë lekë në vit, sepse marrin 80% të rrogës së komisionerit, por e fshehin nën petkun e devotshmërisë për atdheun.

Të falenderoj shumë që je i sinqertë dhe i drejtpërdrejtë!

**Damian Gjikhuri** – Radhën e ka Klement Zguri, i cili ka aplikuar për pozicionin rregullator.

Klement, ju nuk keni nevojë shumë për prezantim, por unë kam një pyetje direkte.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pse përsëri në KQZ? Unë kam mbi 20 vjet që merrem me zgjedhje dhe kam parë që ju jeni një poster i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Mendoj se ndonjëherë njeriu duhet të bëjë pak pushim apo të bëjë diçka ndryshe. Thjesht jam kurioz, por edhe për publikun.

**Klement Zguri** – Është gjëja që di të bëj më mirë, por besoj se i shërbej edhe të përgjithshmes së vendit. Kam pasur kontakt me zgjedhjet në të gjitha komisionet prej kur ka hyrë demokracia, nga të cilat 23 vjet pa ndërprerje i kam në KQZ. Besoj se është një eksperiencë që vlen për t'u konsideruar.

**Damian Gjikhuri** - Klement, kur e dhe dorëheqjen?

**Klement Zguri** – Para dhjetë ditëve.

**Damian Gjikhuri** – Është depozituar dorëheqja?

**Klement Zguri** – Po, po.

**Damian Gjikhuri** – Nuk kemi për çfarë t'ju pyesim, sepse ju njohim.

Natën e mirë!

**Klement Zguri** – Natën e mirë dhe faleminderit!

**Damian Gjikhuri** – Radhën e ka Koli Bele. Ka aplikuar për komisioner dhe komisionin e ankesave dhe sanksioneve.

Zoti Bele, unë personalisht ju njoh, por shumë shkurt, për dy-tre minuta, bëni një prezantim për t'ju njohur të tjerët, çfarë ju shtyu të aplikoni në këto pozicione dhe diçka për formimin tuaj.

**Koli Bele** – Kam pasur fatin të punoj me shumicën e deputetëve të nderuar në pozicione të ndryshme.

Megjithatë, unë kam më shumë se 22 vjet eksperiencë si jurist. Kam punuar në institucione të ndryshme, duke filluar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, kam qenë prokuror, jam angazhuar si avokat dhe si pedagog. Gjatë kësaj periudhe kam pasur kontakt edhe me procese zgjedhore në cilësinë e mbrojtësit ligjor. Më pas kam pasur një eksperiencë publike shumë të mirë në fushën e administrimit si sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Energjisë dhe më pas atë të Arsimit për t'u larguar dhe aktualisht jam pedagog dhe konsulent. Pra, eksperiencia e ndryshme dhe e vlerë në institucionet publike dhe ato private më ka mundësuar të krijoj bindjen që kjo eksperiencë do të ishte po aq e vlefshme në këtë institucion, i cili ka një vazhdimësi të proceseve zgjedhore, që, në thelb, ngelen të njëjta, por ka edhe sfida të reja, të cilat kanë të bëjnë me administrimin, pasi kemi të bëjmë me ngritjen e institucioneve të reja, si institucioni i komisionerit, ashtu edhe KAS-i.

Kam aplikuar duke menduar se, nëse do të vlerësohesha nga ky komision dhe parlamenti, do të isha një kandidaturë që do të sillja më të mirën dhe do të isha vlerë në këto institucione.

Faleminderit!

**Damian Gjikhuri** - Zoti Kristaq Kume ka aplikuar për pozicionin e rregullatorit.

Mirëmbërëma, zoti Kume!

Ju jeni figurë publike e njohur dhe ekspert për çështjet zgjedhore dhe besoj se nuk ka nevojë për prezantim personal, por vetëm mund të na thoni se çfarë ju shtyu t'i ktheheni edhe një herë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve pasi ju keni një eksperiencë të gjatë në të?

**Kristaq Kume** - I kthehem KQZ-së, por me një ndryshim të madh. Radhën e parë shkova pa e ditur se ku shkoja dhe çfarë do të bëja, ndërsa sot e di mirë se çfarë duhet bërë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E qartë. Pas rreth 23 vjetëve që merrem me këtë gjë, besoj se do të jetë akti im i fundit, jo për të nusëruar, sepse jam shumë i vjetër për t'u quajtur nuse, por për të kontribuar në atë që unë mendoj se ka më shumë se çdo gjë tjetër nevojë nga të gjithë ne dhe në mënyrë të veçantë nga ata që kanë eksperiencia të formuara në këtë fushë dhe nuk kanë qenë pak ata që janë prezantuar këtu para jush.

**Damian Gjikhuri**- Nuk kam çfarë pyetjet t'i bëj zotit Kume, sepse të gjithë e njohim dhe kemi pasur fatin, në një mënyrë ose në një tjetër, të punojmë me të.

**Edmond Stojku-** Rikthimi i zotit Kume, në aspektin e ekspertizës, do të ishte vërtet një risi, pasi pas shumë vjetësh dhe pas një ekspertize të gjatë, sidomos në shoqërinë civile, do t'i bënte mirë një organi të ri të riformuar tani.

Lidhur me aspektin moral, nuk kam çfarë të diskutoj, pasi ka qenë i paangazhuar gjithmonë në politikë. Prandaj, mendoj se do të jetë nder dhe kënaqësi të ishit prezent në këtë institucion të ri.

**Kristaq Kume** - Faleminderit!

**Oerd Bylykbashi** - Siç u tha, zoti Kume ka një rekord të gjatë si anëtar i KQZ-së jo vetëm në shoqërinë civile, por edhe në reformat zgjedhore, përfshirë në hartim të legjislacionit zgjedhor, siç kanë një pjesë e kandidatëve që u paraqitën sot, dhe me momente të rëndësishme, që kanë bërë diferencë në momente kyçe dhe problematike të procesit të zgjedhjeve, siç është rasti i listave të zgjedhësve në vitin 2003, ku u hartua një koncept krejt i ri i hartimit të listave.

**Myslim Murrizi** - Fakti që zoti Kume, me të cilin njihemi prej afro 30-vjetësh, ka kandiduar për rregullator është një pozicion teknik, por shumë i vlefshëm dhe i domosdoshëm për mirëfunksionimin e KQZ-së. Edhe pse zoti Gjijknuri nuk ka qejf kur unë e deklaroj votën, por unë ende nuk e kam plotësuar numrin 12 dhe e deklaroj votën time, me të gjithë kokrrën e qejfit, pro zotit Kristaq Kume për te rregullatori.

**Kristaq Kume** - Faleminderit!

Natën e mirë dhe punë të mbarë!

**Damian Gjijknuri** - Kandidatja tjetër është Laureta Bregasi.

Ju lutem, shumë shkurt mund të na tregoni se çfarë ju shtyu të aplikoni në këto dy pozicione dhe mund të na flisni pak për *background-in* tuaj. Mund të flisni 2-3 minuta, në mënyrë që të kemi mundësi t'ju bëjmë edhe ndonjë pyetje.

**Laureta Bregasi** – Quhem Laureta Bregasi. Jam diplomuar në vitin 2006 për drejtësi, kam kryer studime pasuniversitare për të Drejtë Tregtare Ndërkombëtare. Eksperienca në vitet e fundit kanë qenë si drejtuese në sektorin privat dhe publik, ku vitet e fundit kam punuar pranë Ministrisë të Shtetit për Diasporën dhe Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, në drejtorinë juridike.

Eksperienca e viteve të fusnit, si në përpilimin e akteve nënligjore, akteve rregullatorë për institucionet, gjithashtu edhe gjykimi në çështjet e ndryshme juridike kanë qenë motivi kryesor që më ka shtyrë për të kandiduar për këtë pozicion.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jam shkëputur në muajin korrik.

**Damian Gjicknuri** - Pse jeni shkëputur?

**Laureta Bregasi** - Për motive personale. Për të punuar në sektorin privat, si edhe për profesion të lirë si juriste.

**Damian Gjicknuri** – A keni eksperiencë në çështjet e shqyrtimit administrativ, meqenëse keni punuar aplikuar për KAS?

**Laureta Bregasi** - Gjatë periudhës që kam përfaqësuar institucionet ku kam punuar jam marrë me çështje të ndryshme, por më shumë në anën këshillimore dhe, sa i përket sektorit privat, në përpilimin e akteve të ndryshme për t'u paraqitur në gjykatë, por edhe në përgjigjen e ankesave të ndryshme.

Faleminderit!

**Damian Gjicknuri** - Zonja Lealba Pelinku, kandidon në pozicionet komisioner, komisioner rregullator dhe KAS.

Mirëmbërëma, zonja Pelinku!

Ju lutem, na thoni shumë shkurt se çfarë ju shtyu të aplikoni në këto 4 pozicione, si dhe diçka për *background-in* tuaj dhe eksperiencën tuaj. Keni 2-3 minuta kohë, në mënyrë që t'i jepet mundësi komisionit për pyetje.

**Lealba Pelinku**- Studimet e larta i kam kryer në drejtësi në Itali dhe jam diplomuar me pikët maksimale, më pas kam kryer studimet pasuniversitare në master dhe aktualisht jam në prag të përfundimit të studimeve doktorale.

Pasi kam përfunduar studimet jam kthyer në Shqipëri, ku kam punuar fillimisht si juriste dhe më pas avokate në sektorin privat. Nga viti 2006 deri sot kam qenë e angazhuar si pedagoge me kohë të plotë ose të pjesshme në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës.

Në raport me kandidimin tim, dua të veçoj përvojën më të rëndësishme për sa i përket administratës publike, ai i funksionit të anëtarit, zëvendëskryetarit dhe i kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik. Veçantia e këtij institucioni si një kuazi gjykatë dhe përvoja që më ka dhënë të punuarit në atë institucion kanë qenë patjetër të vyera si nga aspekti administrativ, ashtu edhe drejtues. Në këtë kontekst, me anë të instrumenteve të ndryshme kam bërë përpjekjet maksimale për të rritur nivelin e transparencës dhe besueshmërisë së këtij institucioni, siç kanë qenë seancat dëgjimore apo ato që parashikonte ligji i prokurimit publik. Eksperienca si drejtuese ka qenë një eksperiencë që kam marrë dhe kam dhënë, por ajo që ka më shumë vlerë të përmendet është përpjekja për të krijuar një mënyrë apo mekanizma të institucionit që të garantonin efikasitetin, zbatueshmërinë e ligjit, si dhe respektimin e afateve ligjore. Në këtë kuadër, janë ngritur sisteme, edhe pse manuale

asokohe, për gjurmimin e ankimimeve, pra trajtimit të dosjeve të ankimimeve, në mënyrë që të respektoheshin afatet ligjore.

Aktualisht jam pedagoge, asistente/lektore pranë Fakultetit të Drejtësisë.

**Damian Gjikhuri** – A jeni anëtare e ndonjë partie politike?

**Lealba Pelinku** – Jo.

**Damian Gjikhuri** – A keni pyetje? Nuk ka.

Natën e mirë dhe suksese!

Mirëmbërëma!

Ledio, shumë shkurt: keni aplikuar për pozicionin e KAS-it, çfarë të ka shtyrë? Flisni pak për *background*-in tuaj, pra 2-3 minuta jo më shumë.

**Ledio Braho** – Faleminderit!

Kam përfunduar studimet për drejtësi në vitin 2009 në Fakultetin e Drejtësisë, më tej kam ndjekur studimet master me një bursë të shtetit gjerman në Gjermani për të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe ligjin humanitar. Kur jam kthyer, kam punuar për një periudhë kohe në administratë shtetërore në Ministrinë e Integritetit dhe në Inspektoratin Qendror, që ishte një institucion i ri në varësi të Kryeministrit dhe ishte pjesë e reformës rregullatore. Në atë kohë kam asistuar për një sërë ndryshimesh ligjore që u bënë për reformën për inspektime. Më tej, nëpërmjet programit “LEAD Albania”, që është një program që financohet dhe ndiqet nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, kam punuar si këshilltar pranë Presidentit të Republikës, në atë kohë ka qenë Bujar Nishani. Nga fillimi i vitit 2015 jam si profesionist i lirë, si avokat, drejtoj zyrën time të avokatisë. Nga dokumentet që kam sjellë, kam treguar se kam eksperiencë për sa u përket gjykimeve administrative në Gjykatën Administrative. Po ashtu, dua të shtoj edhe faktin që jam pjesë e Komitetit të Disiplinës së Dhomës së Avokatisë; jam zgjedhur nga avokatët nëpërmjet parimit një anëtar një votë. Është një organ kolegjal që merr vendim dhe vendos, kur është rasti, dënime dhe sanksione për avokatët. Kam qenë pjesë e një sërë trupash arbitrazhi, ku nga palë të ndryshme më janë besuar t’i gjykoj çështje të ndryshme, sipas parimeve të arbitrazhit. Mendoj se jam kandidati i duhur për KAS-in, për faktin se me ndryshimet ligjore është risi pjesa e KQZ-së që është ndarë në 3 organe, pra pjesa që është depolitizuar. Besoj se tashmë është momenti që, pas 30 vjetësh që zgjedhjet janë kontestuar në Shqipëri nga të gjithë faktorët pjesëmarrës, por edhe palët e tjera, që personat, të cilët do të jenë pjesë e këtyre organeve, të kenë një integritet të lartë dhe profesionalizëm, pa bindje politike të njërit krah apo të krahut tjetër. Kështu që, për shkak të karrierës sime të deritanishme, besoj se i plotësoj kushtet formale, por edhe të gjitha kushtet subjektive që duhen për këtë detyrë.

Faleminderit! Mirupafshim!

**Damian Gjikhuri** – Lefterie Luzi Lleshi.

Zonja Luzi, ne ju njohin, sepse, në fakt, ju jeni një figurë publike, pra keni qenë edhe kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Thjesht çfarë ju shtyu të aplikoni për një nga këto organe përsëri, sepse nuk ka nevojë për *background*-in tuaj, sepse ne ju njohim?

**Lefterie Luzi Lleshi** – Faleminderit!

Sigurisht, qenia kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është një nga arsytet ligjore, një kërkesat e ligjit për eksperiencën e mëparshme, për të aplikuar për këtë vend. Nga viti 2012-2016 kam qenë në një mandat, por, sigurisht, nuk kam ndaluar aty, pas vitit 2012 kam punuar si eksperte zgjedhore. Në ushtrimin e aktivitetit tim jam udhëhequr, sigurisht, nga parimet e integritetit, paanësisë dhe përgjegjshmërisë. Sigurisht, arsyeja është se e njoh këtë fushë shumë mirë, e njoh nga A-ja te ZH-ja dhe jam shumë komode në këtë fushë. Mendoj se performimi im në këtë detyrë, nëse ju do të vendosni për mua, do të jetë akoma më cilësor se sa i radhës së parë, për arsye se e njoh këtë fushë nga të gjitha anët.

**Damian Gjikhuri** – Mirupafshim, zonja Lleshi!

Për pozicionet rregullator dhe KAS.

Zoti Gremshi, shumë shkurt diçka për *background*-in tuaj dhe çfarë ju shtyu të konkurroni në këto dy pozicione, rregullator dhe KAS? Pra, pse je i përshtatshëm për rregullatorin, pse je për KAS-in, bazuar në eksperiencën tënde?

**Leonard Gremshi** – Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Posaçëm Parlamentar,

Kam shprehur interesin për të kandiduar për vendin vakant të anëtarit të Komisionit Rregullator ose atë të anëtarit të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve.

Duke vlerësuar maksimalisht rolin që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kryen për administrimin e votës të qytetarëve shqiptar, si shprehje e vullnetit të tyre të lirë, dëshiroj të jem pjesë e këtij institucioni të rëndësishëm, pasi edhe edukimi im, si dhe puna gjatë këtyre 13 vjet si jurist më kanë dhënë njohuri shumë të mira në fushën juridike.

Studimet e larta i kam kryer në Itali në Fakultetin e Drejtësisë, në universitetin e Torinos dhe i kam përfunduar në vitin 2007. Në vitin 2008 kam marrë titullin avokat, profesion që e kam ushtruar për shumë vjet deri në vitin 2014, veçanërisht në çështjet administrative, në shkallët e gjykimit administrativ dhe gjyqësor, por, ndër të tjera, edhe në çështjet tregtare dhe civile.

Gjithashtu, kam qenë avokat në projektin “Klinika ligjore për të miturit” i financuar nga UNICEF-i. Më pas kam qenë pjesë e administratës publike në fushën e çështjeve juridike-administrative, në fushën e prokurimit të koncesioneve të partneritetit publik privat, lejeve minerare, ankandeve publike, kontratave publike, kontratave koncensionare. Në nivel zbatues kam qenë jurist në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, ashtu edhe në nivel drejtues, duke i referuar Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe Autoritetit Portal Durrës. Në nivel drejtues kam qenë anëtar dhe zëvendëskryetar i Komisionit të Prokurimit Publik për një periudhë veprimtarie vazhduese gati 3 vjet e 8 muaj në shqyrtimin e ankesave të operatorëve të ndryshëm ekonomikë. Pikërisht lista e gjatë e çështjeve, në cilat jam marrë si avokat, si dhe eksperiencia ime në Komisionit e Prokurimit Publik, ku jam marr drejtpërdrejt me shqyrtimin e ankesave, përpilimin dhe marrjen e vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, më jep siguri të them se kam aftësitë për të shqyrtuar legjislacionin dhe për të zgjidhur në rrugë administrative ankesat, duke treguar paanshmëri dhe aftësi për të përmbushur detyrat që përcaktohen në Kodin Zgjedhor, si për komisioner të rregullatorit ose për komisioner të KAS-it.

Për sa më sipër, mendoj se plotësoj kushtet dhe kriteret që përcakton ligji.

Faleminderit!

**Damian Gjikhuri** – Ku keni mbaruar?

**Leonard Gremshi** – Në Torino, në Itali.

**Damian Gjikhuri** – A ka pyetje? Nuk ka.

Natën e mirë!

**Leonard Gremshi** – Natën e mirë! Faleminderit!

**Damian Gjikhuri** – Vazhdojmë me Lindita Takon për rregullator dhe KAS.

Përsëritje!

Shumë shkurt diçka për veten tuaj, çfarë ju bëri të aplikoni në këto dy pozicioni, por mos e bëni më shumë se 2-3 minuta prezantimin? Cili është *background*-i juaj? Pse është e përshtatshme për pozicionin e Rregullatorit dhe KAS-it eksperiencia juaj legjislative, jo në kuptimin e miratimit të ligjeve, por më shumë rregullshkrimit, hartimit të akteve dhe në shqyrtimet administrative për Komisionin e Ankimeve?

**Lindita Tako** – Unë jam Lindita Tako, kam studiuar në Fakultetin e Drejtësisë në vitin 1991-1995. Menjëherë i jam nënshtruar provimit të avokatisë dhe kam ushtruar profesionin e avokatit deri në vitin 1999. Në vitin 1999 jam kthyer në Komitetin e Zhvillimit të Turizmit në pozicionin e shefes ë Sektorit Juridik, ku për disa vite kam shërbyer në këtë pozicion Drejtorinë Juridike në Ministrinë e Zhvillimit të Turizmit dhe Territorit.



Gjatë gjithë kësaj kohe jemi rritur me legjislacionin, është krijuar legjislacioni në vitin 1994, që nga Kodi i Procedurës Civile, Kodi i Procedurës Penale, Kodi Penal dhe Kodi i Procedurave Administrative në vitin 1999. Gjithashtu, gjatë të gjithë kësaj kohe kemi qenë drejtori që kemi krijuar legjislacionet përkatëse të fushave dhe më pas kemi bërë oponencën për legjislacionet e ministrive të tjera në raport me fushën që ne i përkisnim, pra ne kemi hartuar rregullore dhe akte nënligjore në zbatim të ligjeve të fushave përkatëse që ne mbulonim.

Pra, mund të them që kam një eksperiencë goxha të gjatë deri në vitin 2005, kur jam larguar nga ministria dhe jam punësuar në Këshillin e Ministrave, në DSIK. Edhe këtu kam një eksperiencë në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe mbikëqyrjes së marrëveshjeve për sigurinë e informacionit të klasifikuar.

Pra, gjatë të gjithë kësaj kohe në administratë deri në vitin 2005 jam marrë me drejtoritë përkatëse juridike dhe krijimin e oponencës së akteve normative të fushave që kemi pasur në zbatim atë kohë.

Më pas kam kaluar në një fushë komplet tjetër, në Komitetin Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Provave në komisionin vendor të qarkut Tiranë, ku kam qenë anëtare komisioni për një periudhë. Ato kanë qenë organe kolegjiale dhe kemi zbatuar ligjin e fushës përkatëse.

Më pas jam rikthyer në pozicionin e lirë të avokatisë për t'u kthyer në vitin 2015 në Komisionin Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësisë. Edhe në këtë rast kemi shqyrtuar si organ kolegjial titujt e pronësisë të kontestuar nga të tretët, personat që kanë përfituar me ligjin nr. 7501 për tokën, duke iu nënshtruar një procedurë dhe hetimi admirativ, një vendimmarrje kolegjiale administrative. Më pas, në respektim të parimit të sigurisë juridike, kemi bërë përfaqësimin ligjor pranë gjykatave administrative gjatë të gjithë kohës për vendimmarrjet që merrte Komisioni Vendor i Verifikimit të Titujve të Pronësisë.

Pra, mendoj se kam një eksperiencë të mjaftueshme si në anën e hartimit dhe të oponencës ligjore për të shërbyer në Komisionin Rregullator, ashtu edhe për në KAS mendoj se kam një eksperiencë të mjaftueshme administrative për të shqyrtuar një vendimmarrje administrative. Mendoj se eksperiencia dhe formimi bëjnë që të jem e përshtatshme për këto dy komisione.

**Damian Gjikhuri-** A ka pyetje? Nuk ka.

Natën e mirë!

Kandidatura tjetër është Mimoza Cenaj, e cila ka aplikuar për KAS.

Zonja Cenaj, ju lutem, shumë shkurt, na thoni: pse jeni e përshtatshme për këtë pozicion nisur nga eksperiencia? Çfarë ju shtyu të kandidoni?

**Mimoza Cenaj** - Quhem Mimoza Cenaj, kam përfunduar Fakultetin Juridik dhe kam ndjekur një akademi profesionale, në të cilën jam certifikuar si njohëse e mirë e ligjeve.

Kam punuar rreth 23 vjet në gjyqësor. Në fillim kam qenë kryesekretare në fillim në gjykatën e Sarandës, pastaj në gjykatën e Tiranës për 15 vjet. Kam ushtruar profesionin e avokatisë për disa muaj dhe gjatë kësaj kohe kam mbrojtur edhe çështje administrative, të cilat kanë dalë me sukses. Aktualisht jam ndihmëse ligjore në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Kam aplikuar në këtë pozicion pune, sepse më pëlqen pjesa e ankimimeve dhe e ndjekjes së çështjeve. Mendoj se përvoja ime prej 23 vjetësh në administrimin e çështjeve më ka bërë të përballem me shumë ankimime të çështjeve, të cilat më kanë dhënë një iniciativë, që shpeshherë të vë në praktikë jo vetëm dijet dhe praktikën, por edhe intuitën në zgjidhjen ose aplikimin e çështjeve.

Dëshiroj të provoj diçka të re. Duke pasur parasysh eksperiencën time shumëvjeçare në fushën administrative, mendoj se kam ende për të dhënë. Është një profesion që më pëlqen.

**Damian Gjikhuri** – Ju thatë se aktualisht jeni ndihmëse ligjore në Gjykatën e Apelit. Fakti që Kolegji Zgjedhor është i atashuar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, dhe ju mund të jeni potencialisht anëtare e Komisionit të Ankimeve, a mund të përbëjë kjo një situatë ndikimi, konflikti interesi apo të ketë ndikim në vendimmarrjen tuaj?

**Mimoza Canaj** – Kjo nuk ka të bëjë fare, unë nuk kam lidhje me trupën gjyqësore, që është përzgjedhur për çështjet e komisionerit, nuk kam lidhje fare.

Aktualisht në Gjykatën e Apelit nuk jemi të përcaktuar me gjyqtarë konkretë, sepse jemi një numër i vogël ndihmësish ligjorë dhe ne jemi me ligjin e vjetër, ndërkohë që ligji i ri i cakton ndihmësit më short pranë gjyqtarëve përkatës. Nuk e kemi filluar ende këtë procedurë, sepse priten emërimet e reja nga KLGJ, pas provimit që bëjnë në Shkollën e Magjistraturës.

**Damian Gjikhuri** - A keni pyetje? Nuk keni.

Natën e mirë!

Kandidatura tjetër është Muharrem Çakaj. Zoti Çakaj, ju lutem, shumë shkurt na thoni: çfarë ju shtyu të aplikoni për këtë pozicion, nisur nga *background*-i juaj? Unë ju njoh personalisht, por kjo vlen më shumë për publikun.

**Muharrem Çakaj** – Mirëmbërëma!

Unë jam diplomuar si jurist në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitin 2001. Kam një eksperiencë 19- vjeçare si jurist, avokat në sektorin privat dhe shtetëror. Kam ushtruar të ndryshme, disa nga detyrat që shërbejnë si një bazë shumë e mirë për të kandiduar në organet e reja të KAZ-së janë kryesisht drejtor i Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, që kishte si objekt veprimtarie oponencën ligjore të të gjitha akteve ligjore e nënligjore, kam marrë pjesë në grupe të ndryshme pune për hartimin e kodeve të ndryshme si: Kodi Detar, Kodi Hekurudhor, Kodi Ajror. Siç e dimë të gjithë, kodi është një ndër aktet më të larta në hierarkinë e ligjeve.

Në gjykimin tim personal, reforma zgjedhore, pavarësisht se janë bërë ndryshime në Kodin Zgjedhor, ka filluar, është një bazë shumë e mirë, por nuk ka përfunduar. Aktet nënligjore, të cilat do të hartojnë organet e reja të KQZ-së, ato që do të përcaktojnë mbarëvajtjen e procesit dhe, sigurisht, administrimin dhe organizmin e zgjedhjeve nga organet e reja të KQZ-së më shtynë dhe më motivuan mua personalisht për të kandiduar për këtë pozicion.

Gjithashtu, kam marrë pjesë edhe në cilësinë e ekspertit në Këshillin Politik, përfaqësues ligjor i një force politike, besoj se kolegu e tha pse nuk ka konflikt interesi, por gjithsesi mbetem i hapur për pyetje.

**Damian Gjikhuri** – Përfaqësues i një force politike në KQZ?

**Muharrem Çakaj** – Po, kam qenë përfaqësues ligjor i LSI-së.

**Damian Gjikhuri** – Në detyrën tuaj, nëse do të jeni anëtar i Komisionit të Ankimeve, a do të jeni objektiv ose thjesht një përfaqësues?

**Muharrem Çakaj** – Ligji e kërkon qartazi që nuk duhet të jesh anëtar aktiv i një partie politike, unë besoj e kam dorëzuar edhe në deklarin tim, por kjo është lehtësisht e verifikueshme që nuk jam anëtar aktiv i një partie politike. Së pari.

Së dyti, vizionet që unë kam për organet e reja të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, janë:

1. Pavarësia e anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Transparenca.
3. Qëndrueshmëria në vendimmarrje, e cila është mjaft e rëndësishme.

Çfarë do të thotë? Në gjykimin tim personal duhet të vendoset një precedent dhe sigurisht t'i qëndrojë atij vendimi, pra raste të ngjashme të zgjidhen njësoj.

**Myslim Murrizi** – Zoti Çakaj,

Shoh që keni aplikuar për 3 pozicione...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Komisioner dhe nënkomisioner i quaj si një. Pyetja që ju bëri zoti Gjikhuri nuk është vetëm për ju, sepse në listë nga 53 emra, janë 20 që kanë qenë ministra, deputetë, më shumë tifozë si puna jote, që ke qenë aty përfaqësues i LSI-së. Në cilin nga këto 4 pozicione realisht ju ndiheni më adapt dhe më i qetë në ndërgjegjen tuaj për ta kryer me profesionalizëm atë detyrë?

**Muharrem Çakaj** - Përtej konkurrentëve që kanë qenë zëvendëskryeministra, ministra e të tjera me radhë, personalisht e ndiej veten të aftë që të konkurroj në të katra pozicionet, pavarësisht nëse do të më jepet ky besim nga Kuvendi i Shqipërisë, besoj se do ta realizoj me sukses qëllimin dhe misionin e çfarëdolloj pozicioni që do të më besohet.

Faleminderit!

**Damian Gjikhuri** – Odeta Berberi.

Odeta, shumë shkurt na prezantoni veten, pasi publiku duhet ta njohë. Aktualisht, ku jeni, çfarë *background*-i keni dhe pse aplikoni për këtë pozicion?

**Odeta Berberi** – Përshëndetje!

Unë quhem Odeta Berberi. Kam mbaruar studimet për shkencat politike, kryesisht në Itali, por studimet master i kam zhvilluar edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Miçigan. Studimet e mëpasme doktorale kanë pasur në fokus pjesëmarrjen politike të minoriteteve kombëtare, gjë që do të thotë se kam analizuar sistemet elektorale në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe kam bërë krahasimin midis tyre për sa i përket pjesëmarrjes politike të minoriteteve.

Në eksperiencën time si pedagoge e jashtme pranë Universitetit të Tiranës prej vitit 2011 kam dhënë si lëndë “Sistemet politike në Europën Juglindore”, ku ndër të tjera krahasohen dhe analizohen edhe sistemet elektorale në vendet e rajonit të Europës Juglindore, por, sigurisht me fokus edhe vendet anëtare të Bashkimit Europian, modelet e sistemeve elektorale.

Arsyeja pse aplikova për pozicionin e rregullatorit lidhet edhe me faktin që në vitin 2017 kam qenë pjesë e misionit vëzhgues të OSBE-ODIHR-it në Shqipëri në pozicionin e asistentit të analistit politik, ku ndër tjera sigurisht kam asistuar edhe në hartimin e raportit të misionit të OSBE-ODIHR-it në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017 në Shqipëri. Gjatë periudhës post-doktorale, por edhe në eksperiencën time profesionale në parlamentin e Shqipërisë, në pozicionin e këshilltares për agjendën integruese të vendit, por edhe për proceset dhe agjendën për reformën zgjedhore, sigurisht që e kam ndjekur të gjithë procesin e reformës zgjedhore, duke filluar që me ngritjen e Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore, po ashtu edhe në Këshillin Politik, ku sigurisht i kam ndjekur nga afër të gjitha

zhvillimet dhe kam ofruar asistencën time, atëherë kur më është kërkuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste.

**Damian Gjiknuri** – Vazhdojmë me Odeta Seferin. Ju keni aplikuar për pozicionin e KAS-it. Shumë shkurt *background*-i juaj dhe pse jeni e përshtatshme për këtë pozicion.

**Odeta Seferaj** – Përshëndetje!

Faleminderit për fjalën!

Unë quhem Odeta Seferaj. Kam përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Drejtësisë, në sistemin 3+2. Pasi përfundova Bachelorin 3-vjeçar, kam vijuar me studimet master-shkencor penal në vitin 2014, ku kam përfunduar edhe studimet. Nga shkurti i vitit 2015 e deri më sot kam qenë vazhdimisht e punësuar dhe në marrëdhënie pune në profesionin tim, si juriste fillimisht, dhe pasi përfundova edhe Shkollën Kombëtare të Avokatisë në vitin 2016, prej viti 2017 jam edhe avokate. Kam qenë e punësuar në disa studio ligjore në Tiranë, gjithmonë në sektorin privat, jo në atë shtetëror, si juriste fillimisht dhe pasi përmbusha kriteret, edhe si avokate me një eksperiencë 2-vjeçare dhe prej 1 viti kam edhe zyrën time ligjore dhe jam në sektorin privat.

Kam marrë pjesë në disa çështje, përgjithësisht kam qenë e fokusuar në çështjet civile dhe administrative, prandaj mendova se i plotësoja kriteret për pozicionin në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, pasi kam eksperiencë në zgjidhjen e konflikteve administrative. Pse aplikova këtu? Aplikova, pasi mendova se është një institucion i ri, që po formohet nga e para dhe figura të depolitizuara, siç është edhe emri im, që nuk është lakuar asnjëherë në asnjë parti politike, mund të jepnin kontributin dhe përkushtimin maksimal sa i përket kësaj detyre.

Këto janë arsyet që unë kam aplikuar këtu, për të qenë pjesë e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, nuk kam qenë asnjëherë. Siç jua thashë, kam qenë e punësuar pranë studiove ligjore dhe studiove të avokatisë në Tiranë. Eksperienca ime në këto zyra konsistonte në hartimin e shkresave dhe praktikave të ndryshme për depozitimin në gjykatë, duke ndjekur nga afër edhe gjyqet, për të cilat kam qenë përfaqësuese e palëve.

Kjo është eksperienca ime 5-vjeçare në fushën e drejtësisë.

**Daminan Gjiknuri** – Faleminderit!

**Odeta Seferaj** – Faleminderit juve!

**Damian Gjiknuri** – Zoti Petrit Çanaj.

Mirëmbërëma, Petrit!

Ju jeni prokuror aktiv me shumë eksperiencë, prandaj do të doja një prezantim të shkurtër të karrierës suaj dhe çfarë ju shtyu që të aplikoni për këtë pozicion.

**Petrit Çano** – Aktualisht, siç e thatë edhe ju, kryej detyrën e drejtuesit të prokurorisë së Rrethit të Krujës. Jam i diplomuar për inxhinieri dhe për drejtësi në Universitetin e Tiranës. Për disa vite kam punuar si inxhinier dhe më pas kam punuar si hetues dhe si oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier për një periudhë 10-vjeçare. Në vitin 1997 jam emëruar prokuror me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (pasi në atë kohë edhe prokurorët emëroheshin nëpërmjet Këshillit të Lartë të Drejtësisë), dhe që prej atij viti e deri tani ushtroj detyrën e prokurorit. Gjatë 23 vjetëve që punoj si prokuror, për rreth 20 vjet kam qenë drejtues i prokurorisë në disa rrethe të vendit, duke filluar që nga prokuroria e rrethit Berat për 3 vjet, gati 8 vjet kam punuar në prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe më pas 5 vjet në prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe aktualisht po bëj gati 5 vjet në prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Gjatë kësaj kohe jam përpjekur të kryejë me ndershmëri dhe me korrektesë të gjitha detyrat e ngarkuara. Nuk kam asnjë vërejtje disiplinore gjatë gjithë aktivitetit. Jam vlerësuar me “shumë mirë” në të gjitha rastet. Kam kryer trajnime të ndryshme si brenda dhe jashtë vendit si: Shkollën e Magjistraturës dhe jam angazhuar në disa seminare të organizuara jashtë vendit.

Kjo është pak a shumë përvoja ime.

**Damian Gjikhuri** – Keni kaluar edhe në nivelin e parë të Komisionit të Vetëgjyqësorisë si figurë e pastër.

**Petrit Çano** – Kam kaluar në të tri kriteret pa pasur asnjë problem.

**Damian Gjikhuri** – Do të doja t’ju bëja edhe një pyetje. Meqenëse ju jeni prokuror dhe nga mënyra se si është shkruar ligji, u mëshon më shumë aspekteve të eksperiencës në shqyrtimet administrative. Gjatë karrierës suaj, a jeni marrë me hetime, që lidhen më shumë me pjesën e vendimmarrjeve administrative?

**Petrit Çano** – Jam marrë me hetime penale për çështjet zgjedhore, patjetër, sepse, siç thashë, unë kam qenë në disa rrethe dhe kam kaluar disa procese zgjedhore. Për sa u përket çështjeve administrative, që ju përmendët, mendoj se qenia ime si drejtues për 20 vjet më ka ndeshur me shumë probleme, dhe, natyrisht, edhe çështjet administrative mendoj se janë brenda përvojës që kam pasur në drejtimin e këtyre prokurorive.

**Damian Gjikhuri** - Faleminderit, zoti Çano!

**Myslim Murrizi** – Zoti Çano, nëse do të të kalojmë në komision dhe në parlament, a do të vazhdosh të jesh në prokurori apo do të japësh dorëheqjen?

**Petrit Çano** – Derisa ndërmora këtë iniciativë, besoj se e kam zgjedhur atë që do të bëj. Do të kryej këtë detyrë, nëse do të më jepet mundësia.

**Myslim Murrizi** - E keni kaluar edhe fazën e parë të vetingut?

**Petrit Çano** - Po, e kam kaluar.

**Damian Gjiknuri** - Zoti Çano, faleminderit!

Redinela Beqiraj, nuk është.

Radha për zotin Sali Shehu. Mirëmbërëma, zoti Shehu!

Ne ju njohim, se ju kemi pasur koleg dhe shumë të tjerë ju njohin me vite.

Ju lutem, shumë shkurt, çfarë ju shtyu të aplikoni për pozicionin e komisionerit, nisur edhe nga përvoja juaj?

Koha në dispozicion është 2-3 minuta.

**Sali Shehu** – Së pari, ju falënderoj për kohën që po shpenzoni me ne!

Së dyti, ne njihemi dhe nuk kam nevojë të prezantohem para jush.

Arsyeja thelbësore që më ka shtyrë të futem në këtë konkurrim është fakti se Shqipëria ka nevojë një herë të vetme për zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Ka 30 vjet që të dyja palët e rregulloni ligjin, shkoni në garë, mbaroni ndeshjen dhe rezultati shkon në drejtim të paditur.

Unë mendoj se një KQZ mbi baza ligjore dhe kushtetuese, me vullnet të plotë të kryetarit të saj, të strukturave të reja, që do të ndërtohen, ia del që t'u japë shqiptarëve zgjedhje të lira.

Nuk kam nevojë të flas për vete. Unë besoj në faktin se ndryshimi i ligjit do të sjellë pa diskutim risi të reja për zgjedhjet, gjithashtu besoj se një harmonizim elegant midis komisionerit, strukturave të tjera dhe administratës së KQZ-së do t'ia dalë, edhe një herë e përsëris, t'u japë shqiptarëve zgjedhje të lira dhe korrekte, aq të domosdoshme për vendin tonë sot, që jemi vend kandidat për Bashkimin Europian.

**Damian Gjiknuri** – Faleminderit!

Të dyja palët i godite.

Po ia lë vendin Myslimit, se ai është palë e tretë, se ne dy palët dolëm keq.

**Myslim Murrizi** – Palë e tretë, në fakt, zoti Gjiknuri, prej 31 vjetësh mot, janë vetëm shqiptarët dhe nuk janë as Myslimi, as Damiani dhe as Oerdi. Pra shqiptarët janë pala që gjatë gjithë kohës ka ngrenë shkemat e dy, tri, katër apo pesë palëve në kurriz dhe që flitet shumë në emër të kësaj palës së tretë.

Unë nuk kam qejf të jem as palë e parë, as palë e dytë dhe as palë e tretë. Zoti Shehu me të drejtë tha, dhe unë jam personalisht (meqë m'u drejtua mua dhe ti e di historikun)

viktimë e ikjeve të zgjedhjeve në drejtim të paditur tre herë rresht, që nga “Dushku” i famshëm i vitit 2001, kur më ç’regjistruan si të pavarur në vitin 2005 dhe kur i numëruan votat në drejtim të paditur në vitin 2009.

Unë i mbështes të gjitha çfarë tha zoti Shehu. Absolutisht ka ardhur koha që komisioneri të jetë (jo për sensin e gjinisë) burrë me “B” të madhe, që të mos trembet kur e merr në celular Hasani apo Hyseni.

Faleminderit!

**Damian Gjikhuri** – Për ty e kishte këtë, Sal!

Kemi ndonjë pyetje tjetër? Nuk kemi.

Natën e mirë!

Sokol Bana, ju lutem, bëni një prezantim të shkurtër pse keni aplikuar për këto dy pozicione komisioner dhe KAS? Pse mendoni që begraundi juaj është i përshtatshëm për këto dy pozicione, sepse jemi *live* dhe publiku do të mësojë më shumë? Koha në dispozicion është 2-3 minuta.

**Sokol Bana** – Kam mbaruar studimet në universitetin “La Sapienza” të Romës për drejtësi, sistemin 4-vjeçar. Mandej kam mbaruar Shkollën e Specializimit të Profesioneve Ligjore po në të njëjtin universitet, e njohur nga Ministria e Arsimit si një diplomë e nivelit të III-të. Pas mbarimit të kësaj shkolle, konkurova dhe u bëra pjesë e Shkollës Doktorale, përsëri në të njëjtin universitet, në Departamentin e së Drejtës Publike. Aktualisht sot mbaj gradën “Doktor” në shkencat publike në Fakultetin e Drejtësisë të universitetit “La Sapienza”.

Prej vitit 2008 jam pedagog në universitetin “Ismail Qemali”, me një shkëputje të vogël në administratë. Jam 12 vjet lektor i së Drejtës Administrative dhe të Drejtës Europiane në universitetin “Ismail Qemali”, në të cilin kam mbajtur pozicione të ndryshme drejtuese në harkun e 12 vjetve, duke filluar nga shef Departamenti i Drejtësisë, zëvendësdekan i Fakultetit të Shkencave Humane, dekan i Fakultetit të Shkencave Humane dhe, së fundi, zëvendësrektor i universitetit.

Aplikova për këto pozicione duke pasur prioritet gjithmonë mësimdhënien, mosshkëputja nga mësimdhënia është primare dhe me mundësinë që dha ligji nr. 101/2020, do të doja të jepja një kontribut dhe të merrja një eksperiencë të re edhe në riformatimin e institucionit të KQZ-së.

**Damian Gjikhuri** – Faleminderit, Sokol!

Ka pyetje?



**Myslim Murrizi** – Në respekt të gjithë CV-së dhe të formimit tuaj profesional, do të doja të dija nëse keni qenë regjistruar në Vlorë apo keni punuar te kthimi i pronave?

**Sokol Bana** –Jo, kam qenë regjistruar për një periudhë shumë të shkurtër dhe kam dhënë dorëheqjen.

**Myslim Murrizi** – Sa e shkurtër?

**Sokol Bana** – 5 muaj e gjysmë.

**Myslim Murrizi** – Ju ikët para se hipoteka e Vlorës të transferohej në Shkodër?

Faleminderit!

**Sokol Bana** – Faleminderit, ju, deputet!

**Damian Gjikhuri** – Nuk e di nga e keni këtë informacion që hipoteka e Vlorës ka shkuar në Shkodër.

*(Zoti Murrizi ndërhyr pa mikrofon.)*

Mirë u pafshim!

**Sokol Bana** – Faleminderit!

**Damian Gjikhuri** - ...Spiro Maliqi, rregullator dhe KAS.

Spiro, shumë shkurt, pse keni aplikuar për këto dy pozicione, pse je i përshtatshëm për rregullator dhe për KAS nisur nga kriteret që ka ligji?

**Spiro Maliqi** – I nderuar kryetar,

Të nderuar anëtarë,

Përshëndetje!

Unë jam Spiro Maliqi, vij nga Elbasani, jam jurist, studimet i kam nisur në Grenoble të Francës dhe më pas, për arsye familjare, jam transferuar në Shqipëri, ku kam ndjekur vazhdimin e ciklit të studimeve *bachelor* dhe master, kam marrë titullin jurist i përgjithshëm në fund të *bachelor*-it dhe studimet master për të Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare. Më pas kam ndjekur studimet në Shkollën Kombëtare të Avokatisë, ku dhe jam licencuar si avokat. Pas licencimit si avokat dhe përgjatë kohës së ndjekjes së kësaj shkolle kam ushtruar profesionin e avokatit, në fillim si asistent dhe më pas si avokat privat, më pas jam punësuar në shtet në fillim me kuadrin e programit të studentëve ekselentë në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Drejtorinë e Europës dhe Azisë Qendrore, ku kam punuar si jurist, më pas kam filluar në Njësinë e Zbatimit të Projekteve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhave dhe pranë Ministrisë së Infrastrukturës, si jurist dhe ekspert, dhe më pas kam qenë përgjegjës i Zyrës së Ndhmës Juridike Parësore të Ministrisë së Drejtësisë në Bashkinë e Elbasanit.

Eksperienca ime me zgjedhjet është relativisht e mirë në raport me moshën, kam qenë komisioner, sekretar dhe kryekomisioner, kam zhvilluar trajnime të rëndësishme në lidhje me

fushatat zgjedhore, ku doja të veçoja trajnimet e kryera nga ambasada zvicerane për trajnimin e trajnerëve të të gjithë komisionerëve, ku unë isha përfaqësues i qarkut të Elbasanit, si dhe trajnime të ndryshme të bëra nga OBSE-ja. Gjatë punës si përgjegjës i Zyrës së Ndhmës Juridike Parësore, ashtu dhe gjatë punës si këshilltar i jashtëm i kryetarit aktual të Bashkisë Elbasan jam marrë me përfaqësime të ndryshme administrative, përgatitje aktesh ligjore dhe nënligjore, si dhe me konsulta të ndryshme, që mendoj se më bëjnë të përshtatshëm për këtë lloj pozicioni.

Gjithashtu një motiv tjetër që më shtyu të aplikoj është se duke qenë se janë organe të reja jam i mendimit që duhen njerëz të rinj me frymë europiane dhe me vullnet për të bërë mirë.

Faleminderit!

**Damian Gjikhuri** – Pyetje? Nuk ka.

**Spiro Maliqi** – Faleminderit!

**Damian Gjikhuri** – Atëherë kandidati i fundit, Theodhori Sollaku, rregullator dhe KAS.

Mirëmbërëma, zoti Sollaku!

Ju keni aplikuar për Komisionin Rregullator dhe për Komisionin e Ankimeve, kuptohet që ju jeni një person publik i njohur, të gjithë ne ju njohim nga afër, por të paktën për transparencë dhe informacion për publikun mund të na thoni se çfarë ju shtyu të konkurroni për këto dy pozicione.

Mund ta shtypësh mikrofonin.

**Theodhori Sollaku** – Eksperienca ime gjatë këtyre 34 vitesh përvojë, 22 në strukturat shtetërore dhe pjesa tjetër si avokat më ka krijuar mundësinë që në jetë të provoj sfida dhe eksperienca të reja. Mendoj se si njëra dhe tjetra do të më japin mundësinë që, nëse do të votëbesohem nga Kuvendi, të mund të bëj më të mirën për një proces sa më të drejtë zgjedhor.

Kjo është arsyeja kryesore, aq më tepër që është edhe *part-time* dhe mundëson edhe mësimdhënien, edhe avokatinë.

**Damian Gjikhuri** – Faleminderit, zoti Sollaku!

Ndonjë pyetje? Nuk ka. Ne të gjithë ju njohim dhe i bëni nder këtij procesi.

Zoti Sollaku, natën e mirë!

Faleminderit për interesimin!

**Theodhori Sollaku** – Natën e mirë!

**Damian Gjikhuri** – Mendoj që meqë e përfunduar këtë proces, stafi dhe drejtoria, që është marrë me të gjithë marrjen e dokumentacionit, do të mund të reflektojë aplikimet që kanë bërë, ose nënshkrimet e formularëve të dokumentacionit që mungonte, duke na i sjellë në një format që të gjithë e kemi më të qartë dhe këto ditë do të bëjmë një mbledhje tjetër, në mënyrë që të vazhdojmë me vlerësimin e çdo kandidati, duke ndjekur procedurat, që ka përcaktuar ligji, domethënë mendoj se kështu do të procedohet.

Po.

**Myslim Murrizi** – Faleminderit!

Besoj se kjo është seanca e fundit dhe nuk kemi tjetër për të pyetur. Duke qenë se i ndoqa me aq vëmendje sa munda edhe dje, edhe sot në seancë dëgjimore të 53 kandidatët, që kanë aplikuar për 12 vende, komisioner dhe nënkomisioner, 5 te KAS-i dhe 5 te Rregullatori, do të ishte edhe në nderin e komisionit dhe të Kuvendit të Shqipërisë, pa dashur të bëj as propagandë e as politikë, që të përkrahë ata individë, të cilët kanë, ashtu siç keni përcaktuar ju bashkë me Këshillin Politik në kriteret eksplicite për kandidatët, integritet moral të pa përfolur dhe njerëz, që nuk kanë mëkate në vitet e kaluara as në zgjedhje dhe as në drejtim të mëkateve ndaj publikut. Ajo që unë kam vënë re gjatë gjithë kësaj liste (e habitshme për të gjithë shqiptarët, nëse na ndjekin) është se kanë konkurruar për të numëruar votat e shqiptarëve 7 individë, që kanë ndarë pronat e shqiptarëve, nga të cilët 5 ish-drejtorë të Përgjithshëm të Pronave të Republikës së Shqipërisë. Unë nuk kam pasur personalisht ndonjë konflikt me këtë ent as privilegj, por besoj se shqiptarët e dinë mirë se si prej vitit 1992 e deri sot janë sorollatur në duart e këtyre individëve, të cilët prej 30 vjetësh kanë drejtuar këtë institucion dhe kurrë nuk e kanë gjetur të drejtën dhe kurrë nuk janë ndjerë të vlerësuar për pronën që kanë pasur, pa dashur të përmend emra, se duket sikur i pres në besë meqë nuk i kam përballë. Do të ishte në dinjtetin e komisionit tonë edhe vlerësimin nga jashtë të subjektit politik opozitës jashtëparlamentare, që pavarësisht njohjeve, shkeljeve të syrit, dhënies së fjalës, të mos kishte individë që shqiptarët i shohin si mish dhie dhe, ata që janë prerë në besë, apo nuk u kanë besuar drejtësinë e pronës, nuk do ta besojnë se do t'ua numërojnë drejt votat, apo pushtetin, sepse pushteti kalon nëpërmjet votës në një sistem demokratik. 6 të tjerë shoh që vijnë nga KQZ-ja. Prej 7 palë zgjedhesh organizmat ndërkombëtare, OSBE/ODIHR-i, që mbikëqyrin zgjedhjet, në raportet e tyre nxijnë me të drejtë se si janë zhvilluar zgjedhjet dhe si janë numëruar votat në Shqipëri. Vetë politika njeh '96-n, '97-n dhe 2001-n si njolla turpi në zgjedhjen e qytetarëve shqiptarë. Kështu që kur shoh që marrin kurajën për të kandiduar për t'u rikthyer prapë, për të numëruar drejt besimin e qytetarëve shqiptarë në kutinë e votimit më 25 prill, individë të cilët nga të gjitha palët me

të drejtë janë etiketuar si tjetërsues të vullnetit të qytetarëve shqiptarë, nuk flas për vete, sepse do të dukeshin sikur e kam personale, por '97-a, 2001-i, 2005-a, 2003-i ishin zgjedhje të drejtuara nga disa individë, që shoh se kandidojnë tek organet e reja të kësaj administrate të re zgjedhore. 5 i shoh që vijnë nga një fshat, 3 janë kushërinj të parë. Do të doja shumë nga administrata e Kuvendit, në respekt të kriterëve të përcaktuara në marrëveshje të plotë të 5 qershorit mes jush, zotit Gjicknuri, zotit Bylykbashi, zotit Vasili dhe zonjës Hajdari, keni thënë se duhet plotësuar formulari i vetëdeklarimit të nënshkruar sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit", po ashtu keni thënë që formular aplikimi për informimin përpara emërimit të zgjedhjes së posteve të larta të plotësuar në përputhje me ligjin nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", ndaj ata që ne se bashku do t'i kalojmë, për të shkuar në seancë... Nuk e di se si është ligji i ri. Nuk e kam pasur vëmendjen ta lexoj ligjin e zonjës Sula, por që ne të mos bëjmë organin e inkuizicionit dhe të mos kthehemi si partia e dikurshme, që lëshonte letra, do të doja që të gjithë ata, që do të merrnin besimin e këtij komisioni për të shkuar në seancë, sa më shpejt t'i drejtohen autoritetit, sepse bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit të Shtetit, që rrinë si skutha poshtë tavolinës, për t'iu lëpirë çdo lloj padroni të pushtetit, nuk do të na bëjnë nder dhe nuk do të jetë e moralshme që të votohen për të drejtuar zgjedhjet. Për merakun e kryetarit, besoj edhe të kolegëve, nuk flas kot në hava, zoti Gjicknuri, do ta doja këtë për të gjithë ata që janë të datëlindjes '74 e më mbrapa. Kush ka qenë 16 vjeç në dhjetor të '90-s dhe aplikon këtu, pra kush është sot 46, 47, 48, 49 deri në 110 vjeç, duhet të na sjellë dokumentin nëse ka qenë apo jo spiun Sigurimi. Në dijeninë time (në listën prej 74 vetash, sot kanë ngelur 53), ka të tillë.

Ndaj, që të mos i hyjmë në hak askujt, ata të cilët e mendojnë veten si vazhdues të kësaj beteje, deri në votimin në seancë plenare, duhet të sjellin edhe këtë dokument, sepse ju, zoti Gjicknuri dhe zoti Bylykbashi, këtë e keni përcaktuar së bashku në kriteret që duhet të përcaktojnë kandidatët, si për komisionerë e nënkomisionerë, edhe në KAS, edhe në komisionin rregullator. Prandaj, jashtë tifozaqeve politike, edhe miqësive personale, pushteti, flas për zotin Gjicknuri dhe për zotin Shameti, se Hyseni është me leje, i ka të gjitha mundësitë që të bëjë ndere personale në institucione të tjera. 172 mijë vetë i keni në punë. Nuk besoj se Shqipëria ka ngelur kaq keq.

Me të drejtë, edhe ju, edhe ne, pamë jo pak individë profesorë, që vijnë nga bota akademike, nga jashtë e të papërllyer, madje 14 i numërova unë, që kishin mbaruar në Romë, Torino, Bolonjë e Londër.

Kështu që t'u japim shqiptarëve një trupë zgjedhore të besueshme dhe të heqim dorë nga dreqërit, që edhe kanë firmosur në letër para '90-s, edhe kanë firmosur letra duke ngrohur xhepat pas '90-s.

Faleminderit!

**Damian Gjiknuri** – Më fal, zoti Bylykbashi!

Së pari, në qoftë se procedura e lejon dhe deklaratimet janë plotësuar, nuk e di nëse ka një mundësi verifikimi, sepse nuk e njoh si procedurë, a mund të kryhet ndonjë verifikim i shpejtë? Po. Dakord.

Ata që përzgjidhen duhet ta kenë të detyrueshme, jo të gjithë.

Së dyti, fakti që aplikuan kaq shumë njerëz dhe, siç u tha edhe këtu, ka një numër të madh aplikantësh, është një gjë e mirë, një risi që tregon që ndryshimet e Kodit Zgjedhor dhe mënyra se si u formatua Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka tërhequr interesin e shumë aplikantëve. Unë përgjithësisht jam dakord që individët, që janë dukshëm të asociuar politikisht apo që mund të krijojnë një konflikt të pastër interesi, të mos i përzgjidhnim, por natyrshëm duhet të fokusohemi edhe te kandidaturat, të cilat kanë eksperiencë, që kanë eksperiencë në vendimmarrjet administrative dhe kanë një profil publik të njohur. Natyrshëm zgjedhja është shumë e gjerë aty, pra hapësira është shumë e madhe. Komisioni do t'i shikojë me shumë rigorozitet dhe, kuptohet, brenda procedurave ligjore shpresoj që ne do të përzgjedhim kandidatët më të mirë të mundshëm, brenda atyre mekanizmave që kënaqin edhe balanca politike, që, fatmirësisht apo fatkeqësisht, ne i kemi akoma në mënyrën se si është formatuar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Kështu që ne nuk kemi nevojë të bëjmë deklarime këtu se kush është më partizan në përzgjedhjen e njerëzve më profesionalë, sepse të paktën unë nuk u shpreha për asnjërin, ashtu si të gjithë ne, me ndonjë përjashtim, por, në fund të fundit, kjo është krejt normale, është më mirë e ditur dhe në ligj është shkruar qartë që secili edhe mund të dalë hapur dhe mund të mbështesë ndonjë kandidat, edhe partitë politike mund të mbështesin kandidatë, dhe jo më kot ligjvënësi e ka menduar ashtu, me qëllim që të dihet qartë se kush mbështet kësesa të fshihesh pas maskave gjoja jopolitike.

Kështu që në ditën në vijim do të mblidhemi, siç e lamë, për të shqyrtuar të gjithë dokumentacionin dhe për t'iu rikthyer edhe një herë këtyre intervistave, që publiku dhe ne i pamë, për të zgjedhur kandidatin më të përshtatshëm, kuptohet, në konsultim me përfaqësuesit e Partisë Demokratike, siç kemi rënë dakord në depozitat tranzitore të Kodit.

Faleminderit!

Zoti Bylykbashi.

**Oerd Bylykbashi** - Zoti Gjoknuri, si përfaqësues i posaçëm i opozitës, sipas ligjit, në këtë komision, unë do të shprehja jo thjesht interesin, por edhe shqetësimin në lidhje me përfundimin sa më shpejt të këtij procesi.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi suprem për organizimin e zgjedhjeve të ardhshme, por ka detyra specifike, të cilat çdo ditë që vonon aq më shumë cenon ato që janë arritur në marrëveshjen e 5 qershorit, në mënyrë specifike, identifikimin biometrik, por edhe përgatitjet e tjera.

Dakordësinë e kishim që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të ishte ngritur brenda korrikut. Është data 30 shtator dhe jemi shumë vonë. Jemi ende në faza shqyrtimi dhe nuk kemi vendimmarrje, aq më pak, ende nuk e kemi përcaktuar se kur do të jetë në Kuvend.

Kështu që kërkoj të mos humbasim kohë, të ecim shpejt për këtë pjesë, në mënyrë që edhe këta komponentë të rëndësishëm organizativë për zgjedhjet e ardhshme, të cilët nuk janë thjesht përgatitje rregullash, por edhe përgatitje materiale, që kërkojnë kohë për të garantuar më pas nëpërmjet tyre që vota e shqiptarëve nuk tjetërsohet dhe kutitë nuk mbushen, siç është identifikimi biometrik, të bëhen sa më parë pa vonesë.

Sigurisht që kemi bërë një ndryshim të rëndësishëm në konceptimin e KQZ-së, një organ të cilin e ndërtoam në një formë të caktuar me besimin se do të funksiononte. Ndërhyrjet e vazhdueshme kanë bërë që ai organ të dështonte. Aktualisht është një organ, i cili ka reflektuar një vullnet politik të skajshëm, me veprime antikushtetuese, të kryera nga ai komision, me interes të qartë politik, të njëanshëm, i kritikuar edhe në raportet ndërkombëtare.

Uroj që ky rikonceptim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve do të sjellë një mundësi për një rrugë ndryshe. Megjithatë, siç u tha këtu edhe nga aplikantët, kjo do t'i mbetet zbatimit. Do të shohim nëse ky Komision Qendror i Zgjedhjeve do t'i qëndrojë testit të paanshmërisë dhe pavarësisë politike nëpërmjet kësaj ndarjeje funksionesh dhe kontrolli e balancash, që jemi përpjekur të ndërtojmë në të.

Uroj shumë që maxhoranca, e cila do të përdorë votat e saj për zgjedhjet, por do të bëjë edhe përzgjedhjen e shumicave, apo qoftë edhe të funksionit kryesor ekzekutiv, të mos udhëhiqet nga militanca dhe interesi politik, por nga nevoja që shqiptarët kanë për zgjedhje të lira e të ndershme, madje mund të shtojmë edhe atë për zgjedhje normale.

Është viti 2020 dhe zgjedhjet në Shqipëri janë një spektakël i konfliktit politik dhe i shkeljes shpeshherë të rregullave në mënyrë brutale dhe të të drejtave të zgjedhësve shqiptarë. Kështu që në 2021-shin duhet të jetë jo thjesht procesi zgjedhor i radhës, por të jetë fillimi i një procesi zgjedhor, i cili i kthen shqiptarët në normalitet.

Në vitin 2009 u arrit, sipas ODIHR-it, shumica dërrmuese e standardeve. Kemi shkuar shumë pas. Të fillojmë të rikthehemi aty ku ishim më shumë se 10 vjet më parë.

Faleminderit!

**Damian Gjikhuri** - Për ta mbyllur, se nuk ia vlen, edhe unë ju falënderoj për kontributin! Mbase për shtesë, mbas të gjitha atyre që u thanë, si nuk uroi njeri, të paktën për herë të parë në Shqipëri, që rezultati të pranohet! Unë këtë do ta quaja revolucionin më të madh.

*(Diskutime pa mikrofon)*

## **MBYLLET MBLEDHJA**